

48/
20

1.07.2019.

RAPORT

I VLERËSIMIT TË JASHTËM


Për Programin e studimit Master Profesional në: “Teknologji dentare e avancuar”

Ofruar nga Universiteti “Aldent”

Ekspertët e vlerësimit të jashtëm:

Prof. As. Dr. Nazmi KOÇI

Prof.As. Etleva DROBËNIKU (QELI)



(Qershor / 2019)

RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Për Programin e studimit Master Profesional në: “ Teknologji dentare e avancuar”

Tabela e të dhënave të licencimit për programin e studimit:		
1	IAL Aplikues:	Universiteti “Aldent”
2	Fakulteti që e ofron	Fakulteti i Shkencave Dentare
3	Urdhëri/VKM i licencimit/riorganizimit	Urdhër Nr. 190, date 20.04.2018
4	Titulli i programit të studimit:	Master Profesioanl në: “Teknologji dentare e avancuar”
5	Cikli i studimit:	Cikli i dytë i studimit
6	Kohëzgjatja e programit të studimit:	1 vit akademik
7	Kreditet në total (ECTS):	60 ECTS
8	Forma e studimit (me kohë të plotë/të pjesshme/në distancë/):	Me kohë të plotë
9	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha shqipe
10	Programi ofrohet nga institucioni	Po
11	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera	-
12	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
13	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
14	Niveli në Kornizën kombëtare të kualifikimeve	Niveli i 7 (shtatë)
15	Numri i studentëve në këtë program studimi	9

Shenim: Tabela plotësohet nga Specialisti i ASCAL

HYRJE

Te dhena Për Programin e studimit MP në Teknologji dentare e avancuar”

Universiteti Aldent e ka nisur aktivitetin e tij që nga viti 2003, fillimisht nën emrin Shoqëria Aldent, e njohur në fillim si person juridik me vendimin Nr.29008 të datës 06.02.2003 të Gjykatës së rrethit gjyqësor Tiranë. Kjo shoqëri me Urdhër Nr. 76 datë 03.04.2003 të Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës ka hapur shkollën dy vjecare për laborant dentar në vitin shkollor 2003-2004. Pas tre vitesh experience, kësaj shkolle me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr.673, datë 27.09.2006, i është dhënë leja për hapjen e Shkollës së Lartë Universitare jo publike ALDENT.e cila nga ky vit ka vazhduar të përgatisë specialistë të lartë të profilit “Laborant Dentar”. Me vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.257, të datës 27.02.2008, është licensuar programi i integruar i studimit të ciklit të dytë në “Stomatologji”, që vijon me pesë vite akademike me kohë të plotë. Në Universitetin ALDENT, me Urdhër të Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës Nr. 299, datë 22.07. 2013, janë licensuar edhe dy programe studimi të ciklit të tretë që janë: “Specializim afatgjatë në Ortodonti” dhe “Specializim afatgjatë në Kirurgji Orale” dhe që janë akredituar me Urdhër Nr.112, datë 11.03.2016.

Me Urdhër Nr. 190 datë 20.04.2018 të Ministrisë të Arsimit, Sportit dhe Rinisë është licensuar programi i studimit të ciklit të dytë “Master Profesional ne Teknologji Dentare e Avancuar”. Për këtë bën fjalë raporti që po hartojmë. Ky program është hapur për herë të parë në vitin akademik 2018-2019, me kohëzgjatje 1 vit akademike (60 kredite), në sistemin e studimeve me kohë të plotë. Në fillim të vitit akademik 2018-2019 në kete program studimi janë regjistruar 11 studente, por për arsye të tyre dy nga keta i kanë ndërprerë studimet dhe tani vijojnë regullisht 9 studente. Aktualisht në Programin e studimit Master Profesional ne Teknologji Dentare e Avancuar japin mësim 18 pedagogë nga të cilët 14 staf PAE dhe 4 staf PAK. Raporti student / pedagog të brendshëm është 1/2.

Statusi i këtij institucioni të Arsimit të lartë jo publik Mjekësor, ka ndryshuar me Urdhër Nr. 539, datë 13.06.2013 nga Shkollë e Lartë Universitare në Universiteti “ALDENT”. Më pas me Urdhër të Ministrisë të Arsimit dhe të Sportit Nr.115, datë 13.03.2017, është kryer riorganizimi institucional i Universitetit ALDENT me tre Fakultete si më poshtë:

1. Fakulteti i Shkencave Dentare;
2. Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike;
3. Fakulteti i Shkencave Mjekësore.

Në mars të vitit 2016 është bërë akreditimi institucional nga ASCAL me eksperte ndërkombëtar dhe ky akreditim konsiderohet i vlefshëm deri në vitin 2022 sipas Vendimit Nr.111, datë 11.03.2016. Gjatë këtyre viteve që nga fillimet e tij në vitin 2003, Universiteti ALDENT ka krijuar fizionominë e tij të plotë si një shkollë e lartë e profilit Mjekësor, ka kompletuar stafin mjekësor pedagogjik, e atë administrativ sipas kërkesave të ligjit për arsimin e lartë.Ka përmirësuar në mënyrë bindëse edhe bazën materiale e teknike në funksion të qëllimit e misionit të tij që lidhet me përgatitjen e kuadrove të lartë të fushës së Mjeksisë. Këtij qëllimi i shërben edhe kërkesa e paraqitur për akreditimin e programit MP në Teknologji Dentare të Avancuar.

GRUPI I VLERËSIMIT TË JASHTËM (GVJ)

Prof. As. Nazmi Koçi

Prof. As. Etleva Droboniku

Gjatë gjithë procedurës, ekspertët e jashtëm të vlerësimit janë asistuar nga specialistja e ASCAL Znj. Majlinda Demirneli .

Universiteti Aldent është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 14.06.2019, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 48/18 Prot, datë 14.06.2019. Universiteti Aldent përcjell nëpërmjet sistemit AMS më datë 19.06.2019 përgjigje në lidhje me Draft – Raportin e Vlerësimit të Jashtëm, ku shpreh dakordësinë me përmbajtjen e këtij Draft Raporti. Në këtë mënyrë Draft Raporti merr formën e tij përfundimtare si Raport i Vlerësimit të Jashtëm.



1. Misioni / Objektivat e programit të studimit

Terma reference: Qëllimet dhe objektivat e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, strategjitë afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata, ndjekja dhe përshtatja e objektiveve dhe e qëllimeve me kohën, të dhëna të përgjithshme për IAL.

Universiteti ALDENT ka percaktuar si mision te pergjithshem pergatitjen e specialisteve te larte te fushes se Mjeksise dhe eshte profilizuar vetem ne kete drejtim. Ai synon pergatitjen cilesore te tyre dhe paisjen me dije te nivelit bashkekohor me ane te mesim dhenjes, formimit praktik dhe kerkimit shkencor. Ky Universitet synon tu ofroje studenteve mundesi per te perfituar nga arsimi i larte gjate gjithe jetes, pra mundesine per te marre njohuri gjate studimit ne shkolle, por dhe menyren per punuar e mesuar vazhdimisht ne jete. Departamenti Laborant Dentar ne UAL , i cili eshte pjese perberese e Fakultetit te Shkencave Dentare dhe vepron si njesi baze mesimore dhe kerkimore shkencore, ofron mundesi studimi per te gjithe ata studente qe deshirojne te ndertojne karieren e tyre ne fushen e Mjeksise Dentare dhe kane interes per teknikat e pergatitjes se protezave dentare. Programi i studimit MP në “Teknologji Dentare e Avancuar” ka per qellim qe ti paise ata me nje game sa me te gjere te njohurive teorike dhe praktike ne fushen e teknikes dentare. Kjo mundesi ofrohet gjate studimeve te ciklit te pare, qe zgjat tre vite akademike te plota dhe i pais ata me Diplome Bachelor. Mbeshtetur ne strategjine e zhvillimit institucional, Universiteti ALDENT, ne vitin akdemik 2018-2019 ka ofruar programin e ciklit te dyte Master Profesional ne Teknknologji Dentare e Avancuar dhe kerkon akreditimin e ketij programi. UAL eshte ne konsultim dhe asistence te plote te specialisteve me ne ze te fushes perkatese, me qellim pergatitjen e specialisteve te larte me njohuri e aftesi bashkekohore teorike dhe praktike dhe ka ndjekur trendin e nevojave te sherbimit dentar brenda dhe jashte vendit. Ne perputhje me kete qellim jane percaktuar edhe objektivat e programit te studimit Master Profesional ne Teknologji Dentare e Avancuar.

Disa nga objektivat e ketij programi jane:

- Ne perfundim te tij kandidatet te jene te afte qe t’ju pergjigjen kerkesave te larta profesionale, estetike e funksionale lidhur me teknikat e pergatitjes se protezave dentare e maksilo faciale te kohes sone;
- Te zotrojne sa me shume metoda dhe teknologji moderne te protezimit dentar bashkekohor;
- Te marrin njohurite e nevojshme te teknikave te protezimit ne disa fusha qe nuk jane njohur mire me pare dhe qe nuk jane elaboruar sa duhet ne programin e meparshem te studimit te ciklit te pare si pergatitja e protezave mbi implante, protezat kirurgjikale dhe epitezat e fetyres, aparatet ortodontike qe sherbejne per korigjimin e anomalive tek femijet etj;
- Te marin njohurite e duhura profesionale, por edhe menaxheriale qe i bejen ata te afte te orientohen shpejt ne mjedisin profesional brenda apo jashte vendit dhe te zoterojne mire aftesite per te punuar sipas rrethanave te pavarur apo ne gryp ne bashkepunim me kolege te tjere;




- Te njihen me metodat dhe protokollet e kerkimit shkencor per te qene te afte te behen pjese e grupeve te punes qe kryejne vezhgime e kerkime shkencore , apo per te mundur ata vete qe te iniciojne e kryejne kerkime te tilla ne fushen perkateses. etj.1



Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve ¹
Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	
<p>Kriteri 3 Programet e studimeve hartohen në përputhje me misionin dhe qëllimin e institucionit;</p> <p>Kriteri 4 Programet e studimeve hartohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;</p> <p>Kriteri 5 Programet e studimeve hartohen në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit;</p> <p>Kriteri 6 Programet e studimeve pasqyrojnë vullnetin e institucionit për ruajtjen e vlerave kulturore të kombit.</p>	<p>Programi i studimit Master Profesional ne Teknologji Dentare e Avancuar eshte hartuar ne perputhje me misionin dhe qellimin e UAL. Ai ka per qellim ti ofroje tregut specialiste te larte te afte ne fushen e pergatitjes se protezave dentare e maksilo faciale dhe te aparateve ortodontike qe korigjojne anomalite e dhembeve e te nofullave te femijet. Ky program ploteson nje boshlllek qe lidhet me kurikulen e deri tanishme lidhur me teknikat e reja te protezimit te dhembeve sidomos protezat mbi implante dhe epitezat e fytyres. Programi ne fjale permban teknika, materiale dhe aparatura te reja e bashkekohore qe e rrisin nivelin e sherbimit perkates ne nivel europian e botror. Ky program eshte ne perputhje me misionin dhe qellimin e Institucionit per pergatitjen e specialisteve te larte ne fushen e teknikave te zevendesimit te dhembeve .</p> <p>Programi i studimit eshte hartuar ne perputhje me nevojat e tregut te punes. Ai ploteson nje boshlllek duke filluar nga nevojat e vete institucionit dhe me gjere ne shkalle kombetare e nderkombetare. Te gjithë laborantet dentar qe kane mbaruar ciklin e pare te studimeve ne kete institucion jane te punesuar dhe mbajne lidhje me institucionin. Hapja e ketij programi studimi eshte edhe kerkese e tyre. Nje pjese e stafit ndihmes te UAL qe jep mesim ne Departamentin e laboranteve dentar, krahas kualifikimeve brenda e jashte vendit ka kerkuar hapjen e nje programi te plote studimi per Master Profesional si nevojë per plotesimin e njohurive te reja ne kete fushe. Intervistat me institucione te sherbimit dentar privat e shteteror kane paraqitur nevojën e hapjes se nje programi te ciklit te dyte ne fushen e teknologjise</p>

¹ GVJ duhet të shprehen me shkrim për çdo standard në mënyrë të përmblëdhur (mbështetur në kriteret majtas). Në fund të çdo rubrike, grupi duhet të japë mendimin e tij për përbushjen e standardeve në tërësi.




	<p>dentare. Programi i studimit Master Profesional ne Teknologji Dentare e Avancuar eshte hartuar ne perputhje me nivelin ekonomik, teknik e profesional te sherbimit ne vendin tone. Ai ka per qellim te shoqeroje zhvillimet e medha qe kane ndodhur ne stomatologjine shqiptare edhe ne fushen e protezimit te dhembeve ku momentalisht verehet nje prapambetje relative. Cikli i pare studimeve me afat trevjecar qe u jep studenteve diplome te tipit Bachelor shenon nje rritje te nivelit ne kete drejtim. Programi i tanishem i ciklit te dyte konsiderohet si permbylles dhe eleminon diferencat qe kane ekzistuar deri me sot midis pjeses klinike dhe asaj laboratorike te sherbimit dentar. Ky program, pasqyron vullnetin e ketij Institucioni per ruajtjen e vlerave kulturore e profesionale te vendit tone. Ne kurikulat e lendeve verehet se kane zene vendin e duhur disa probleme qe jane me specifike per vendin tone dhe qe jane kapercyer ne vende te tjera te Europes. Ne kete kuptim programi i ofruar veç karakterit profesional e shkencor ka edhe karakter kombetar.</p>
<p>Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.</p>	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve janë përshtatur me strategjinë për zhvillim të institucionit;</p>	<p>Ne strategjine e Institucionit per vitet 2016-2020 jane percaktuar vizioni dhe misioni i tij si dhe nje strategji e qarte qe shkon ne harmoni me strategjine e zhvillimit kombetar. Programi i ofruar i kontribuon misionit per te realizuar formimin e specialisteve te fushes se mjeksise me dije profesionale e shkencore bashkekohore, te afte per ti ushtruar ato brenda dhe jashte vendit. Ky program i sherben thellimit dhe kualifikimit profesional e shkencor te specialisteve te larte te fushes perkatese duke ofruar mundesi te mira per te perfituar nga arsimi i larte dhe per te mesuar gjithe jeten. Programi ne fjale jep kontribut dhe eshte ne mbeshtetje te prioriteteve strategjike dhe interesave te zhvillimit te vendit. Stategjia e Institucionit ne fushen organizative, ne drejtim te infrastruktures, te edukimit e procesit mesimor dhe kerkimor e shkencor dhe personelin akademik jane te pasqyruara e te harmonizuara me programin e ofruar Master Profesional ne Teknologji Denatre e Avancuar.</p>
<p>Standardi I.3 - Programet e studimeve ofrohen në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.</p>	

<p>Kriteri 1 Përmbatja e programeve të studimeve është në përputhje me kriteret e përcaktuara nga aktet ligjore dhe nënljore në fuqi;</p> <p>Kriteri 2 Emërtimi i programit të studimit është në përputhje me nivelin e kualifikimit të arritur dhe të përcaktuar nga Korniza Shqiptare e Kualifikimit.</p>	<p>Programi i studimit u përgjigjet kërkesave të Ligjit Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”.</p> <p>Programi i studimit Master profesional ne Teknologji Dentare e Avancuar eshte hapur sipas sistemit ECTS dhe ka detyrimin te plotesoje 60 kredite gjate nje viti akademik studimesh me kohe te plote. Eshte koherent lidhur me afatin kohor te percaktuar ne ligjin e arsimit te larte qe e lejon kete jo me pare se viti akademik 2018-2019. Ne hapjen dhe realizimin e suksesshem te ketij programi jane patur parasysh e plotesuar me kujdes edhe te gjitha udhezimet e MAS qe u kushtohen studimeve te larta ne sistemin tone arsimor. Programi eshte hapur ne konformitet te plote me statutin e Institucionit dhe rregulloren e studimeve te Universitetit ne percaktimin e tipologjise se lendeve, moduleve perkatese, kryerjes se praktikave profesionale dhe detyrimin per kryerjen e nje Punimi Diplome qe konsiderohet detyrim i ketij programi.</p> <p>Programi i studimit Master Profesional ne Teknologji Dentare te Avancuar eshte ne perputhje me Kronizen Shqiptare te Kualifikimeve dhe i korespondon nivelit te 7 te saj.</p>
---	--

Standardi I.11 - Institucioni harton një plan zhvillimi të programeve të studimeve, të rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.

<p>Kriteri 1 Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucioni për zhvillimin dhe përmirësimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucioni për përmirësimin e rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.</p>	<p>UAL ka hartuar nje plan strategjik ne nivel institucioni qe lidhet me permiresimin e programeve te studimeve dhe permiresimin e vazhduar te rezultateve te mesimdhennes dhe pervesimit te njohurive profesionale e shkencore te kandidateve. Ky plan permban edhe objektiva qe lidhen me permiresimin e games dhe llojshmerise se programeve qe ofron dhe programi ne fjale Master Profesional ne Teknologji Dentare te Avancuar. Ky program ka te percaktuara objektiva te qarta , konkrete, reale e te realizueshme, te cila perputhen jo vetem me startegjine e institucionit, por edhe prirjet dhe perspektivat e zhvillimit te ketij profesioni. Ne strategjine e Institucionit jane te percaktuara disa masa efektive qe lidhen me permiresimin e mesimdhennes dhe pervesimin cilesor te programit te ofruar. Keto masa kane objektiva lidhur me permiresimin e perberjes se stafit, permiresimin e infrastruktures dhe punen me studentet e jane ne fokus te rritjes se cilesise se mesimdhennes dhe arritjes se rezultateve te mira e plotesimin me sukses te programit.</p>
---	---

Konkluzionet e vlerësimit:

Programi i studimit Master Profesional ne Teknologji Dentare e Avancuar eshte hartuar ne perputhje me kerkesat ligjore e aktet nenligjore ne fuqi, dhe eshte ne perputhje te plote me strategjine e zhvillimit te Institucionit si dhe Strategjine e zhvillimit te arsimit ne vendin tone.


2. Struktura akademike e Fakultetit (Departamenti përgjegjës për programin e studimit)

Terma reference: përbërësit e njësisë dhe stafet e tyre, kompetencat, Baza e të dhënave të njësisë, freskimi i vazhdueshëm i saj dhe përgjegjësitë e mbajtjes dhe dhënies së informacionit

Ne Universitetin Aldent jane zbatuar dispozitat e ligjit Nr. 80/2015 “Per Arsimin e larte dhe kerkimin shkencor ne R. e Shqiperise” dhe ne frymen e tij jane bere ndryshimet perkatese ne Statutin e Universitetit si dhe Struktura organizative e Institucionit (Shih shtojca Nr. 5). Ky Universitet i ka percaktuar njesite perberese te tij si dhe rolin e kompetencat e çdo njesie, lidhjet e raportet dhe varesite qe kane njesite me njera tjetren. Ne keto rrethana ky Universitet funksionon ne kushte normale dhe sipas kerkesave ligjore te arsimit te larte ne Shqiperi. Universiteti ALDENT perbehet nga Njesite organizative kryesore, njesite baze dhe ato ndihmese. Me poshte po paraqesim Organigramen e instrucionit:

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Struktura akademike e Fakultetit (organigrama)



Programi “Master Profesional ne Teknologji Dentare e Avancuar” ofrohet nga Departamenti i Laboranteve Dentare i Fakultetit të Shkencave Dentare pranë UAL qe eshte edhe njesia kryesore qe bashkerendon mesimdhenjen me kerkimin shkencor dhe aktivitetin profesional i cili u mundeson studenteve te kryejne praktikat profesionale dhe u sherben njerezve ne nevoje (falas ose me pagesa minimale), pra eshte nje sherbim qe i sherben mesimit , por dhe qe ka nje impakt social pozitiv. Fakulteti i Shkencave Dentare ofron programe studimi te llojeve e niveleve te ndryshme. Struktura , perberja , funksionimi , dhe drejtimet e punes se ketij Fakulteti percaktohen ne rregullore e tij. Aty

jane te percaktuara menyra e organizimit, modalitetet dhe funksionimi i veprimtarise pedagogjike, detyra e administrates, te drejttat dhe detyrat e studenteve, sigurimi i standarteve dhe i cilesise se mesimdhenjes dhe i kerkimit shkencor.

Fakulteti i Shkencave Dentare eshte i organizuar ne tre njesi baze qe jane:

1. Departamenti i Stomatologjise;
2. Departamenti i Laboranteve Dentare;
3. Qendra e Sherbimit dhe Formimit Klinik;

Te dhena lidhur me Personelin Akademik per çdo njesi baze : PAE, PAK, PA, titujt e gradat shkencore, moshen , detyrat konkrete qe kryejne ne procesin mesimor edukativ e kerkimin shkencor dhe detyrat perkatese ne Programin Master Profesional ne Teknologji Dentare e Avancuar gjenden ne Tabelat Nr. 1,2,3,4,5 e 6 te ketij Raporti. Te dhenat e paraqitura ne Raportin e Vleresimit te Brendshem nga ana e Institucionit u verifikuan ne teren dhe u organizuan takime me te gjitha pjestaret e njesive perkatese, pjese e ketij programi dhe rezultoi se te dhenat e paraqitura jane korekte e te sakta.

Fakulteti i Shkencave Dentare në vitin aktual 2018-2019 ka në përbërjen e tij 49 personel akademik efektiv dhe me kontratë. Personel Akademik Efektiv (PAE) janë gjithsej 27 persona, nga të cilët 8 janë me tituj/grada, ndërsa Personel Akademik me Kontratë (PAK) janë gjithsej 22, nga të cilët 13 me tituj/grada.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Struktura akademike e Fakultetit

Dekani është autoriteti drejtues i fakultetit, i cili e përfaqëson atë dhe vepron në emër dhe për llogari të tij. Ai emerohet ne detyre nga Rektori per nje periudhe 4-vjecare me te drejte rizgjedhje.

Departamenti është njësia bazë mësimore kërkimore, që përfshin fusha kërkimi homogjene dhe grupon disiplinat mësimore përkatëse. Objekti i mësimdhënies dhe i kërkimit shkencor të departamentit përfshin disa disiplina të një shkence. Veprimtaria, programet dhe projektet e departamenteve miratohen nga dekani.

Përgjegjësi i departamentit drejton njësinë bazë duke u mbështetur në funksionet dhe kompetencat e parashikuara në statutin, rregulloren, apo aktet e tjera të institucionit, si dhe vepron në përputhje me parashikimet e bëra në Ligjin 80/2015 datë 22.7.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, apo akte nënligjore në fuqi.

Nder te tjera pergjegjesi i departamentit drejton gjithë punen mesimore e shkencore, harton planet e programeve mesimore per lendet qe zhvillon departamenti. Gjithashtu pergjegjesi i departamentit i paraqet dekanit cdo vit raportin per aktivitetin mesimor dhe shkencor te departamentit.

Të dhëna për Stafin akademik të Departamentit përgjegjës

Departamenti i Laboranteve Dentare, i cili është përgjegjës për programin e studimit Master Profesional në teknologji Dentare e Avancuar, gjate vitit akademik 2018-2019 ka ne perberjen e tij gjithsej 13 personel akademik, nga ku **10 personel akademik efektiv (PAE)**, nga ku 2me titullin Prof.As, dhe 2 me gradën Dr, dhe **3 personel akademik me kontrate (PAK)**, nga ku 1me gradën Dr.

Shenim: TE dhena te plota mbi perberjen , strukturen , moshen dhe kualifikimin shkencor te kuadrit ndodhen ne Aneks ne tabelat 1,2,3,4,5,6.

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.2 - Institucioni organizohet në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi, për përmbushjen e misionit të tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni organizohet në mënyrë që të përmbushë misionin e tij;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni ka së paku dy Fakultete;</p> <p>Kriteri 3 Fakulteti organizohet në njësi bazë. Çdo fakultet ka, së paku, tri të tilla, nga të cilat dy departamente;</p> <p>Kriteri 4 Fakulteti ose Instituti i Kërkimit dhe Zhvillimit përbëhet nga, së paku, 3 njësi bazë me objektiva dhe mision të mirëpërcaktuar;</p> <p>Kriteri 5 Departamenti duhet të ketë në përbërje të tij të paktën 7 anëtarë efektivë si personel akademik, ndër të cilët të paktën 3 duhet të jenë me gradën shkencore “Doktor”.</p>	<p>Universiteti Aldent është i organizuar në përputhje me kërkesat e ligjit për arsimin e lartë 80/2015, akteve nën ligjore dhe Udhëzimeve të MAS për arsimin e lartë.</p> <p>Universiteti Aldent, pas riorganizimit të kryer me Urdhër Nr.115, datë 13.03.2017 të MASR, përbëhet nga tre njësi kryesore:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Fakulteti i Shkencave Mjekesore Teknike; 2. Fakulteti i Shkencave Mjekesore; 3. Fakulteti i Shkencave Dentare; <p>Fakulteti i Shkencave Dentare që ka organizuar hapjen dhe plotësimin e këtij programi ka në përberjen e tij këto njësi baze:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Departamenti i Stomatologjisë; 2. Departamenti Laboranteve Dentare; 3. Qendra e Shërbimit dhe Formimit Klinik; <p>Departamenti si dhe qendra e Shërbimit dhe e Formimit Klinik, kanë detyra dhe mision të përcaktuar qartë, janë të gjitha në funksion të procesit mesimor edukativ dhe të praktikave mesimore të studenteve dhe në shërbim të pacientëve, kryesisht atyre në nevojë. Të tre njësitë baze edhe pse kanë detyra të ndara qartë, janë komplementare dhe funksionojnë në mënyrë unike në dobi të procesit mesimor e të kërkimit shkencor në Institucion.</p> <p>Në përberje të njësitë baze të Fakultetit të Shkencave Dentare ka në sejcilën prej tyre me shumë se 7 anëtarë efektivë si personel akademik dhe me shumë se tre prej tyre, janë me tituj shkencor “Profesor”, “Prof.AS.” ose “Dr. i Shkencave Mjekesore”.</p> <p>Departamenti i Laboranteve Dentare ka në përberjen e tij 10 pedagogë efektivë (PAE) nga të cilët 4 me tituj të grada.</p>
Standardi II.3 - Njësitë e institucionit angazhohen drejtpërdrejt dhe me përkushtim për realizimin e programeve të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Njësitë bazë dhe kryesore janë të ndërgjegjshme për përgjegjësitë që kanë për realizimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Njësitë bazë dhe kryesore përfshihen</p>	<p>Fakulteti Shkencave Dentare si njësi kryesore, si dhe Departamenti Laborant Dentar si njësi baze janë të ndërgjegjshëm për risitë e këtij programi studimi i cili hapet për herë të parë në këtë Institucion dhe për herë të parë në vendin tonë. Kjo i ka bërë ata të ecin në rrugë të</p>

në procesin e rekrutimit të personelit akademik të nevojshëm dhe në vlerësimin e tij.

reja dhe janë ballafaquar kryesisht me eksperiencat e vendeve të zhvilluar të Europës lidhur me këtë problem. Ata i kanë përcaktuar qartë detyra dhe ndarë përgjegjësitë që lidhen me programin dhe punojnë të përkushtuar për realizimin me sukses të tij. Përgjësia e njesise baze dhe asaj kryesore vërehet që në hartimin e programit, bazueshmerine ligjore në hapjen e funksionimit të tij, përzgjedhjen e stafit të aftë e kompetent dhe të përkushtuar në këto detyra, përzgjedhjen e kandidatëve të pranuar në këtë program dhe veçanërisht monitorimin e implementimit të plotë e të suksesshem të tij.

Fakulteti i Shkencave Dentare dhe Departamenti i laboranteve Dentar në AU për të realizuar me sukses këtë program studimi, krahas infrastruktures së nevojshme i kanë kushtuar kujdes veçanërisht përzgjedhjes dhe rekrutimit të stafit akademik efektiv apo me kontrate. Kjo punë ka nisur që në hartimin me kujdes të kriterëve specifike për vendin e punës, duke vlerësuar si prioritarë përgatitjen e mirë profesionale e shkencore të kandidatëve për të qenë pjesë e stafit, seleksionimit e përzgjedhjes së kujdesshme të tyre dhe krahas tyre dëshires dhe motivimit të tyre të plotë për të kryer detyrat në këtë fushë. Në shqyrtim disa praktika të tilla dhe konstatojmë se komisioni i ngritur për këtë qëllim në nivel Fakulteti, kishte bërë përzgjedhjen e të gjitha të dhenave të secilit kandidat sipas një procedure të përcaktuar qartë që me parë dhe të zbatuar me korektësi. Kështu është arritur të shpallet me objektivitet fituesi dhe propozimi konkret i ka kaluar Rektorit të Universitetit për aprovim.

Konkluzionet e vlerësimit:

1. UA, pas riorganizimit të kryer me Urdhër Nr.115, datë 13.03.2017 të MASR përbëhet nga tre fakultete. Struktura organizative është në përputhje me aktet ligjore e nënligjore dhe e ndihmon të realizojë misionin e tij. Ky Universitet funksionon si një Institucion i Arsimit të lartë, i specializuar në fushën e përgatitjes së kuadrove të lartë të fushës së Mjekësisë, ka Statutin dhe rregulloren e tij dhe bashkërendon procesin e mesimdhënies me kërkimin shkencor dhe praktikën profesionale si dhe ofron shërbim mjekësor për pacientë në nevojë.
2. Me organizimin e krye, me stafin akademik që ka rekrutuar dhe infrastrukturen e nevojshme të plotësuar pa hezitim, ky institucion është i aftë të kryej detyrën për përgatitjen profesionale e shkencore të specialistëve të Stomatologjisë dhe realizimin e programit Master Profesional në Teknologji Dentare e Avancuar.
3. Departamenti i laboranteve dentare plotëson kriteret si për personelin akademik në total, ashtu edhe për kërkesat në lidhje me kualifikimin e tij.

3. Personeli akademik dhe personeli mbështetës për programin e studimit

Terma reference: Të dhëna për kualifikimin e Personelit akademik, ndarja e tij në Personel Akademik Efektiv (PAE) dhe Personel Akademik me Kontratë (PAK), Personel Administrativ (PA), raporti PAE/PAK, raportet: Personel akademik/Personel administrativ/student; nevojat për Personel akademik/ administrativ, shpërndarja e ngarkesës për personelin akademik, marrëdhëniet me strukturat e tjera jashtë kohës së punësimit, kriteret e rekrutimit të personelit akademik, etj.

Numri i Personelit Akademik Efektiv (PAE) dhe Personelit Akademik me Kontratë (PAK), titujt/gradat;

Personeli akademik i departamentit kryen veprimtari të mësimdhënies, kërkimit-shkencor dhe shërbime në përputhje me detyrat e përcaktuara dhe të rregulluara me Kontratën Individuale të Punës. Mësimdhënia në këtë program studimi është mbuluar kryesisht nga pedagogë të brendshëm

Stafi akademik i ngarkuar për të realizuar programin Master Profesionl në Teknologji Dentare e Avancuar është me tituj shkencor si Prof.Dr, Prof. As., Dr,dhe Msc. Personeli akademik efektiv realizon me shume se 90 % të orëve mesimore të programit të ofruar. Ky program studimi është hapur për here të pare në kete vit akademik.

Për vitin akademik **2018-2019** personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi është **18** pedagogë gjithsej, nga të cilët **14** janë personel akademik efektiv (PAE),nga ku 6 me tituj/grada dhe 4 personel akademik me kontratë (PAK), nga ku 2 me grada

Raporti PAE/PAK në këtë program për vitin akademik aktual është **14/4**.

Raporti PAE/Totalit të personelit akademik në këtë program për vitin akademik aktual (2018-2019) është **14 / 18 = 77 %**.

Raporti personel akademik / student për vitin akademik aktual është **18/9**.

Të dhënat sipas kualifikimit dhe Raportet midis tyre

Personeli akademik që meret me zhvillimin e programit Master Profesional në Teknologji Dentare e Avancuar përbehet gjithsej nga 18 antare, nga të cilët 14 janë efektiv i UA dhe 4 janë marre me kontrate sipas kriterëve të kerkuara.

Sipas shkallës së kualifikimit për zhvillimin e programit janë aktivizuar 2 Prof.Dr., 3 Prof.As., 2 Dr. të Shkencave mjeksore, 2SPA dhe 4Msc.

Keshilli shkencor i programit të studimit përbehet nga 3 antare, nga të cilët 1 Prof.Dr. dhe 2 Dr. Kordinatore e programit është Prof Dr. Ruzhdie Qafmolla.

Gjatë procesit të rekrutimit është realizuar vlerësimi sipas kriterëve të përcaktuara me pare dhe për këtë është përdorur një sistem pikezimi si me poshte :

Të dhënat sipas seksit

Për vitin akademik 2018 – 2019 raporti meshkuj/femra për këtë program studimi është **3/15**.

Kontratat e punës, njohja me detyrat dhe të drejtat

Pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe vizitës në zyrën e burimeve njerëzore, konstatoam se kontratat e punës që nënshkruhen në Universitetin Aldent lidhur me stafin akademik, janë në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Kontrata e punës mbështetet në ligjin nr. 80/2015 datë 22.7.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”

dhe në dispozitat ligjore dhe nënligjore në fuqi që kanë të bëjnë me arsimin e lartë jo publik në Republikën e Shqipërisë, ligjin nr.7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar si dhe në dispozitat ligjore dhe nënligjore në fuqi në lidhje me marrëdhëniet e punës në Republikën e Shqipërisë. Kontratat e punës në AU janë ndare në tre lloje: staf akademik efektiv, staf akademik me kontrate dhe staf administrativ/ndihmes. Kontratat që nënshkruhen me pedagogët efektivë dhe ata me kontratë administrohen nga zyra e Burimeve Njerëzore e cila është përgjegjëse jo vetëm për arkivimin e dokumentacionit dhe ruajtjen e tij në vite, por edhe për gjenerimin e statistikave vjetore.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.1 - Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ angazhohen për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me objektivat e programeve të studimeve dhe për arritjen e tyre;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.</p>	<p>Stafi akademik për implementimin e programit Mp në Teknologjin Dentare e Avancuar është përzgjedhur me kujdes dhe sipas aftësive të spikatura mesimdhënëse, profesionale e shkencore që të realizojë me kujdes programin e ofruar. Masat e marra për realizimin e programit, hapsirat e nevojshme, infrastruktura dhe baza materiale në dispozicion i krijojnë stafit akademik mundësi reale e të plota për kryerjen me sukses të kësaj detyre. Edukimi aktiv teorik e praktik i studenteve rrit në një shkallë më të lartë dashurinë e tyre për profesionin, respektin ndaj pacientëve dhe kolegëve si dhe aftësitë profesionale e shkencore për tu ballafaquar me sukses me situata klinike sa do të vështira qofshin dhe për të zgjidhur me sukses ato. Në strategjinë e Institucionit ka rregulla të percaktuara qarte për rekrutimin e stafit që janë zbatuar edhe për plotësimin e këtij programi. Kjo del nga praktikat që grupi i vlerësimit të jashtëm verifikoi në terren gjatë vizitës në Institucion.</p> <p>Personeli akademik ndihmes i UA në fushën e përgatitjes së Laborantëve Dentare është me eksperiencë të madhe profesionale e mesimdhënëse, i rekrutuar e i kualifikuar vazhdimisht ndër vite. Një pjesë e tij ka bërë edhe kualifikime plotësuese jashtë vendit lidhur me teknika e aparatura të reja që përdoren lidhur me protezimin e dhembëve dhe që janë pjesë e kurikulës së këtij programi. Në UA mund të thuhet me të drejtë se stafi akademik dhe personeli ndihmes që është zgjedhur për</p>

implemtimin e programit eshte nga me cilesoret qe ka aktualisht ne tregun shqiptar.

Standardi II.4 - Personeli akademik angazhohet në hartimin dhe zbatimin e politikave të zhvillimit të institucionit.

Kriteri 1 Personeli akademik luan rol kryesor në hartimin e kurrikulës dhe në vendimet institucionale që i përkasin organizimit të programeve të studimeve;

Kriteri 2 Rekrutimi i personelit të ri dhe përcaktimi i ngarkesës mësimore bëhet në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Stafi akademik i Institucionit eshte hartues direkt i kurikules se ketij program studimi. Ai per kete qellim ka marre ne konsiderate te gjitha nevojat e sherbimit dentar shiptar dhe kerkesat e kohes per permiresimin cilesor te tij. Duke qene se ne vendin tone ne kete drejtim ka munguar eksperienca e meparshme, personeli akademik qe ka hartuar kurikulen ka shfrytezuar edhe eksperienca te vendeve te zhvilluara te Europes, kryesisht ate angleze, per programin e studimit ne fjale. Eshte bere kujdesi i duhur qe eksperienca e huaj te mos implementohet ne menyre mekanike, por ajo eshte studjuar e pershtatur me kushtet e vendit tone. Kjo te ben te mendosh se tanime kemi nje kurikul, veper e stafit akademik te UA, me nivel europian dhe me karakter shqiptar. Ne kete kuptim ajo eshte origjinale dhe zgjidh problemet e tregut mjeksor shqiptar.

Rekrutimi i personelit akademik ne UA eshte bere ne perputhje me kerkesat ligjore te Kodit te punes dhe te akteve qe ky institucion ka nxjerre ne zbatim te tij si Statuti, rregulloret dhe procedurat e percaktuara per kete qellim. Ne keto akte ka kerkesa te pergjitheshme per ata qe kerkohet te pranohen dhe qe jane hartuar nga Dekanati i Fakultetit te Shkencave Dentare dhe kerkesa specifike qe i ka paraqitur Depdepartamenti i Laboranteve Dentar. Personat e rekrutuar kane lidhur kontrate me Institucionin, ku veç te tjerave eshte percaktuar detyra qe do te kryej punonjesi, koha e punes, ngarkesa sipas nevojës qe ka institucioni si dhe te drejtat dhe detyrat e paleve. Per te gjitha keto ka bazueshmeri ne ligj dhe aktet nenligjore dhe ne asnje rast nuk u vrej mbingarkese e punonjesve. Ne kontraten e punes, ne nje nen te saj (neni 10, pika 4) ishte shenuar se punonjesi ka te drejte te largohet kur te doje duke lajmeruar nje muaj para punedhesisin. Kjo u argumentua me kerkesen e Kodit te punes. Ne vleresimin e GVJ kjo e drejte eshte teper e liberalizuar per vete karakterin e punes ne nje Universitet. Se pari mendoj se nuk do ishte e drejte qe procesi i mesimdhenies te lihet ne mes te vitit dhe njerezit te largohen kur te duan. Kjo dhe per

	<p>faktin se per to Institucioni shpesh ka investuar lidhur me formimin e tyre brenda apo jashte vendit dhe largimi kaq i pa pritur nuk i jep atij kohen e nevojshme per zevendesimin e punonjesit qe largohet.</p>
<p>Standardi III.1 - Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin dhe vlerësimin e personelit.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin e personelit në përputhje me statutin dhe rregulloren;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përbën së paku 70% të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programeve respektive të studimeve;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të vlerësimit të personelit;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni mban një bazë të dhënash të raporteve të rekrutimit të personelit, të njoftimeve për vende vakante, etj.</p>	<p>Fakulteti i Shkencave Dentare me qellim realizimin e sukseshem te programeve studimore qe ofron ndjek nje praktike te qarte per rekrutimin e stafit akademik, ndihmes shkencor dhe administrativ, me kohe te plote dhe me kohe te pjeseshme sipas nevojës qe ka. Nje praktike e tille eshte ndjekur edhe per realizimin e programit Mp ne Teknologji Dentare e Avancuar. Procedura e rekrutimi te stafit akademik eshte realizuar sipas kerkesave ligjore, por dhe ne aktet e Institucionit te cilat jane te qarta e te respektuara ne meyre korekte.</p> <p>Eshte Departamenti perkates qe ne perputhje me detyrat dhe ngarkesen mesimore, i paraqet Dekanit kerkesen per vende te lira pune dhe kriteret specifike qe duhet te plotesoje kandidati. Dekani pasi ka marre kerkesen me shkrim nga Departamenti se basku me kriteret qe duhet te plotesoje, i kerkon Rektorit aprovimin per fillimn e procesit per rekrutimin e nevojshem. Pas aprovimit te tij, burimet njerezore shpallin vendin vakant ne faqen zyrtare te Institucionit. Me pas kjo zyre grumbullon dosjet e kandidateve . Dekanati me pas ngren komisionin perkates per shqyrtimin dhe vleresimin e kandidateve gje qe eshte bere duke perdorur nje sistem pikezimi Ky sistem vlereson me pike te gjitha te dhenat e kandidatit si eksperienca ne pune, kualifikime te ndryshme, botimet brenda e jashte vendit, titujt apo graden shkencore qe ka, rekomandimet nga autoritete apo institucione ku ka punuar, intervista e dhene etj, dhe realizon nje total deri ne 100 pike ne rastin me te mire. Keshtu Institucioni ka rekrutuar ata qe kane realizuar me shume pike dhe u ka dhene prioritet atyre qe kane kryer kualifikime e specializime dhe kane kualitet profesional e shkencor me te larte.</p> <p>Per realizimin e programit MP ne Teknologji Dentare e Avancuar jane aktivizuar 18 pedagoge gjithsej nga ku, 14 pedagoge me kohe te plote dhe 4 pedagoge</p>




	<p>me kontrate.</p> <p>Personeli akademik efektiv (PAE) i angazhuar në programin e studimit përbën 77% të personelit akademik në total, 14 nga 18 personel gjithsej.</p> <p>Rreth 90% e programit MP ne TDA realizohet nga pedagoget efektive te UAL. Aktiviteti dhe veprimtaria e stafit akademik eshte vleresuar vazhdimisht me procedura te rregullta e transparente.</p> <p>Universiteti Aldent, bazuar ne Statutin dhe Rregulloren e tij, ka plotesuar dhe ruan dokumentacionin e nevojshem qe lidhet me rekrutimin dhe mbarevajtjen e punes se personelit akademik. Senati i Universitetit ne zbatim te Statutit dhe rregullores se Institucionit ka miratuar Formularin per vleresimin e performances ne perputhje me te drejtat dhe detyrat e pershkruara ne pershkrimin e kerkesave te vendit te punes. Ky formular eshte plotesuar periodikisht dhe ka vleresime lidhur me arrijtet e personelit ne procesin e mesimdhenjes, zhvillimin cilesor te leksioneve, dhenjen e asistences dhe konsultimeve per studentet, kerkimin shkencor, pjesmarjen ne aktivite shkencore, botimet shkencore dhe nxitja e synimet per te ardhmen. Institucioni mban dokumentacion te rregullt lidhur me rekrutimin dhe kualifikimin e vazhduar te stafit dhe personelit akademik. Jane te ruajtura te gjitha procedurat e perzgjedhjes dhe kualifikimit te kuadrit dhe disponohen te dhenat e nevojshme te pesonelit akademik te cilat ruhen dhe trajtohen ne menyre konfidenciale.</p>
<p>Standardi III.2 - Personeli akademik (me grada shkencore dhe tituj akademikë) mbulon nevojat e institucionit dhe i ka të përcaktuara qartë përgjegjësitë.</p>	
<p>Kriteri 1 Përgjegjësi i programit ka të paktën titullin “Profesor i asociuar” ose, gradën shkencore “Doktor” (“PHD”) të fituar pranë universiteteve perëndimore dhe përvojë akademike në këto universitete;</p> <p>Kriteri 2 Titullari i lëndës/modulit në programet e studimeve “Master i Shkencave” ka të paktën gradën shkencore “Doktor”;</p> <p>Kriteri 3 Titullari dhe pedagogët e lëndës/modulit në programet e studimeve “Master profesional” ka të paktën gradën shkencore “Doktor” ose, diplomën “Master Profesional” ose “Master Shkencash” dhe një përvojë profesionale së paku 5-vjeçare në profesionin në të cilin ofrohet ky</p>	<p>Përgjegjësjë e Departamentit te Laboranteve Dentare Dr Edlira Dedaj qe eshte edhe pergjegjese per kete program studimi ka graden shkencore Dr., dhe eksperience akademike mbi 10 vjet. Ne kontraten individuale te punes i ka te pecaktuara qarte detyrat e pozicioni te punes qe kryen.</p> <p>Titullaret e lendeve dhe te moduleve ne programin e studimit Mp ne Teknologji Dentare e Avancuar kane grade ose titull shkencor sipas kerkesave, Prof.Dr, Prof.As. ose Dr. Shkencave mjeksore. Per vete vecorite e programit te studimit disa pedagoge jane laborante, sherbejne si personel ndihmes dhe kane titull Msc e marin pjese ne zhvillimin e praktikave</p>

program studimi;

Kriteri 4 Rektori, zv/rektori, drejtori dhe zv/drejtori i qendrës ndëruniversitare, dekani, zv/dekani, drejtori, përgjegjësi i departamentit, përgjegjësi i shërbimit, përgjegjësi i programit janë të punësuar me kohë të plotë në institucionin që ofron programin e studimeve;

Kriteri 5 Institucioni siguron personel të mjaftueshëm për udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e praktikave profesionale.

profesionale. Ne te gjitha rastet edhe gjate zhvillimit te ketyre praktikave, ato udhehiqen e mbikqyren nga personeli efektiv i Institucionit me eksperiencen e duhur e me kualifikim te plote profesional e shkencor.

Titullaret pedagoget e lendeve dhe te moduleve qe zhvillojne mesim ne kete program te ciklit te dyte kane te gjithe tituj e grada shkencore. Midis tyre nga pedagoget efektive qe jane 14, ka 2 me titull Prof.Dr., 3 Prof. AS., 2 Dr., 1 eshte ne proces te mbrojtjes se Doktoratures, 2 jane me SPA ne fushen e Stomatologjise dhe 4 Msc. Keta te fundit jane te angazhuar kryesisht si personel ndihmes gjate kryerjes se praktikave profesionale te cilat kryhen gjithmone nen mbikqyrjen e pedagoqeve efektive.

Gjthashtu zhvillojne mesim ne kete program edhe 4 pedagoge me kontrate te cilet jane: 2 Dr., 1 SPA dhe 1 Msc. Jo vetem titullaret por te gjithe pedagoget qe zhvillojne mesim ne Programin Master Profesional ne Teknologji Dentare e Avancuar kane stazh mbi 5 vjet dhe po ashtu eksperience pedagogjike dhe klinike. Institucioni ka siguruar personel te mjaftueshem dhe me aftesite e duhura shkencore e pedagogjike per zhvillimin e programit, pasi ne te aktualisht vijojne studimet 9 kandidatet dhe jane aktivizuar per zhvillimin e programit 18 pedagoge, 14 efektive dhe 4 me kontrate.

Drejtuesit e njësive, Rektori, Zv. Rektori, Dekani, Zv. Dekani, Pergjegjesi i Departamentit, pergjegjesi i programit jane te gjithe te punesuar me kohe te plote dhe brenda kriterave qe kerkon detyra qe mbulojne.

Institucioni ka siguruar personel te mjaftueshem per udheheqjen dhe mbikqyrjen e praktikave profesionale, ka bilanc pozitiv ne favor te studenteve pasi per 9 kandidatet qe vijojne programin jane te aktivizuar 18 pedagoge dhe raporti eshte 2:1. Gjithashtu te gjithe pedagoget jane specialiste te fushes perkatese dhe kane eksperiencen e duhur klinike, shkencore e pedagogjike.

Standardi III.5 - Studentët që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave” apo programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë kanë udhëheqës për tezën.

<p>Kriteri 1 Studentët që ndjekin këto programe studimesh kanë një udhëheqës për punën kërkimore dhe tezën që përgatisin për marrjen e diplomës në përfundim të studimeve të këtij cikli;</p> <p>Kriteri 2 Udhëheqësi ka të paktën gradën shkencore “Doktor”;</p> <p>Kriteri 3 Udhëheqësi nuk mbikëqyr më shumë se 5 (pesë) studentë njëkohësisht për temat me karakter kërkimor të aplikuar (si ato të ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave të natyrës, shkencave mjekësore, etj.) dhe më shumë se 10 (dhjetë) studentë njëkohësisht për temat e ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave shoqërore e humane.</p>	<p>Studentet që ndjekin programin e ciklit të dytë Master profesional në Teknologji Dentare e Avancuar në fund të studimeve do të përgatisin një punim Diplome me të cilin do të zgjidhin raste klinike nga praktika klinike që kryhet në këtë Institucion. Për këtë qëllim secili ka një udhëheqës për punën kërkimore shkencore. Është pozitiv fakti se në Universitetin Aldent në saj të mundësive njerzore e materiale që janë krijuar në muajin Shkurt 2019 është kryer një kualifikim një javor i 10 Mjekeve stomatologe nga Izraeli në kuader të bashkpunimit të UA me Klinikën Clalit Smile të Izraelit. Ky kualifikim në fushën e protetikes së levizeshme është kryer nga dy pedagogë shqiptar, njëri prej të cilëve efektiv i UA. Punimet që ata kanë bërë për pacientë shqiptarë në nevojë janë realizuar pikërisht nga studentët që vijojnë studimet e ciklit të dytë në Mp në Teknologji Dentare e Avancuar. Ky fakt është një arritje për studentët e këtij programi dhe institucionin që e ofron pasi një aktivitet i tillë për kualifikimin e mjekeve të huaj në Shqipëri është i pari i këtij lloji në vendin tonë. Gjithashtu ka qenë përveçse një arritje shkencore edhe një veprimtari bamiresie për pacientët shqiptarë. Udhëheqësit shkencorë që ndjekin punimet dhe angazhimet e tjera shkencore të studentëve pjesëmarrës të këtij programi, kanë tituj e grada shkencore duke filluar nga Dr. Shkencave, Prof. As. Dhe Prof. Dr.</p> <p>Udhëheqësit që mbikëqyrin punimet shkencore dhe angazhimet e tjera me karakter shkencor të studentëve të këtij programi nuk udhëheqin më shumë se 2 ose 3 studente në të njëjtën kohë.</p>
<p>Standardi III.6 - Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit dhe është parashikuar të përgatitet teza.</p>	
<p>Kriteri 1 Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit.</p> <p>Kriteri 2 Udhëheqësi ka njohuri të avancuara teorike dhe aftësi të veçanta kërkimore në fushën në të cilën ofrohet programi i studimeve dhe në të cilën është parashikuar të hartohet teza.</p>	<p>Udhëheqësit e punimit të Diplomes për kandidatët e këtij programi, janë të gjithë specialiste të fushës perkatese. Ata janë të specializuar në fushën e Protetikes Dentare, kanë shkruar artikuj e libra dhe kanë mbrojtur tituj shkencorë në këtë fushë.</p> <p>Në këtë program studimi udhëheqësit e punimeve të diplomes kanë njohuri të thelluara teorike e praktike të fushës, kanë edhe eksperiencën e nevojshme</p>

klinike, kerkimore shkencore dhe pedagogjike per detyren qe kryejne dhe udheheqjen e kandidateve.

Standardi III.7 - Institucioni angazhon personel ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ për përmbushjen e misionit të tij.

Kriteri 1 Institucioni dëshmon një angazhim optimal të personelit ndihmës mësimor-shkencor për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve shkollore;

Kriteri 2 Institucioni dëshmon një përdorim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të dytë.

Programi i studimeve te ciklit te dyte MP ne Teknologji Dentare e Avancuar eshte ndertuar ne harmoni midis pjeses teorike dhe asaj klinike e praktike. Kryerja e praktikave profesionale ne kete program studimi konsiderohet shume e rendesishme dhe ka mbeshtetje serioze si ne drejtim te bazes materiale e infrastruktures se nevojshme ashtu edhe lidhur me tutoriatin dhe monitorimin e vazhdueshem e te kujdesshem te çdo seance e punimi qe kryhet aty. Personeli ndihmes eshte i angazhuar non stop gjate gjithë periudhes se zhvillimit te praktikave dhe punimeve konkrete qe kryhen gjate programit. Ai ka nje ngarkese krejt te arsyeshme dhe mbulon kete detyre pa asnje shqetesim. Pervec personelit ndihmes qe eshte gjithmone i pranishem dhe ndihmues ne çdo veprim qe kryhet, keto praktika ndiqen e monitorohen edhe nga personeli akademik qe gjithashtu ndjek e vlereson nga afer te gjitha seancat praktike qe kryhen ne realizim te kletij programi studimi. Institucioni ka bere organizimin e puneve per shfryzimin optimal te burimeve njerezore kryesore e atyre ndihmese ne funksion te mbarevajtjes se programit. Vec puneve brenda procesit mesimor, kandidatet do te dergohen per te zhvilluar praktika profesionale jashte institucionit per probleme te veçanta ne institucione te tjera me te cilat jane lidhur marveshtje konkrete. Nje gje e tille eshte realizuar per disa kandidate duke i derguar jashte shtetit per specializime afat shkurtra per teknika te reja e aparatura te nivelit te fundit. Disa studente jane derguar ne Gjermani ku kane mare nocionet e perdorimit te aparaturave kompjuterike te sistemeve CAD- CAM qe sherbejne per dizenjimin dhe prodhimin ne menyre kompjuterike te protezave te ndryshme apo epitezave te fetyres. Kjo eshte vertet fjala e fundit e teknikes se protezimit sot ne bote. Jane hedhur hapa serioze per sjelljen e ketyre apraturave nga UA, jane levruar parate dhe pritet ardhja e venja ne perdorim te tyre çka e konsiderojme nje sukses te madh jo vetem lidhur me realizimin e ketij programi, por edhe per zhvillimin e stomatologjise shqiptare ne pergjithesi. Nje pjese e

	<p>stafit është trajnuar në Gjermani, midis tyre edhe disa studente të këtij grupi, ndërsa instalimi dhe venja në shfrytëzim të këtij sistemi, kualifikimi i të gjithë atyre që do të punojnë me të dhe mirëmbajtja e sistemit, janë kontraktuar si detyra të firmës furnizuese dhe për të gjitha këto UA ka livruar të gjithë shumën e parave të nevojshme që lidhet me këtë operacion madhor. Ky sistem do të shërbejë jo vetëm realizimit të suksesshem të këtij programi, por krijimit të traditës pozitive dhe punës e objektivave në të ardhmen.</p>
--	--

Standardi III.8 - Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi.

<p>Kriteri 1 Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi;</p> <p>Kriteri 2 Ngarkesa mësimore e zhvilluar nga personeli akademik në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë dhe organizimi e drejtimi i tyre, vlerësohen me orë mësimore.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit, GVJ është i mendimit se ngarkesa mësimore realizohet në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi si dhe kontratës së lidhur me UA.</p> <p>Drejtuuesi i departamentit në kordinim me të gjithë anëtarët e stafit akademik që në fillim të vitit mesimor akademik ka përcaktuar ngarkesën mësimore për secilin sipas kërkesave ligjore dhe udhëzimeve të MAS. Nuk u konstatuan raste të mbingarkesës së stafit, dhe janë lënë hapsira edhe për studime pune shkencore brenda e jashtë institucionit.</p> <p>Ngarkesa e stafit akademik në programin e studimit Mp në Teknologji Dentare e Avancuar është planifikuar me orë mesimore, çka mundëson edhe verifikimin e realizimit e monitorimit të saj gjatë zhvillimit të programit.</p>
--	---

Standardi III.9 - Institucioni disponon një bazë të dhënash për personelin e tij.

<p>Kriteri 1 Institucioni disponon një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon për secilin semestër listën e plotë të personelit akademik, të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe personelit administrativ;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni përcakton dhe publikon kriteret dhe procedurat për rekrutimin e personelit akademik.</p>	<p>Lidhur me personelin akademik që është angazhuar në realizimin e këtij programi studimi të ciklit të dytë, UA disponon dokumentacionin e nevojshëm dhe të dhëna të hollësishme rreth tij. Zyra e Burimeve njerzore që i posedon këto të dhëna i ruan ato në mënyrë konfidenciale, i rifreskon në mënyrë të vazhdueshme. Në këtë kuader këto të dhëna janë plotësuar e ruhen si për përgjegjësin e programit ashtu edhe për të gjithë personat e tjerë që janë angazhuar në realizimin e tij. UA disponon për të dy semestrat listën e plote të personelit akademik, të personelit ndihmës dhe të personelit administrativ që është angazhuar në zhvillimin e programit të studimit të ciklit të dytë Mp në Teknologji Dentare e Avancuar.</p>
--	--

Institucioni ka percaktuar dhe publikuar ne te gjitha rastet e nevojshme kriteret dhe procedurat per rekrutimin e stafit akademik te nevojshem per te realizuar veprimtarine mesimore dhe kerkimore e klinike qe zhvillon. Kjo eshte bere sipas standarteve ligjore e akteve nen ligjore qe lidhen me kete problem. Procedurat e nevojshme qe jane ndjekur per kete problem jane te pasqyruara edhe ne dokumentacionin baze te Universitetit, si Statuti dhe rregullorja e tij. Lidhur me kerkesat specifike per çdo rast te veçante Dekanati dhe zyra e Burimeve njerezore i ka hartuar ato sipas rastit dhe nevojës. Sipas ketij modeli dhe kesaj procedure eshte vepruar edhe per rekrutimin e personelit te nevojshem qe lidhet me zhvillimin e programit te studimit Mp ne Teknologji Dentare e Avancuar

Konkluzionet e vlerësimit:

1. Stafi akademik i UA qe zhvillon programin e ciklit te dyte Mp Ne Teknologji Dentare e Avancuar eshte perzgjedhur sipas kerkesave te ligjit per Arsimin e Larte e kerkimin shkencor ne Republiken. e Shqiperise Nr.80/2015, akteve nen ligjore perkatese, Udhezimeve te MAS dhe Statutit e Rregullores se Institucionit.
2. Ne perzgjedhjen e stafit akademik dhe ndihmes qe meret me zhvillimin e ketij programi eshte vleresuar si prioritare eksperiencia e gjate klinike dhe pervoja e kandidateve ne fushen pedagogjike dhe ate kerkimore e shkencore, gjithashtu jane zbatuar procedura te qarta e korekte, shoqeruar me dokumentacionin perkates perzgjedhur e vleresuar nga nje komision prej 5 antaresh dhe me fituesit jane lidhur kontrata te rregullta pune.
3. Personeli akademik efektiv (PAE) i angazhuar në programin e studimit përbën 77% të personelit akademik në total, **14 nga 18** personel gjithsej, rreth **90%** e programit MP ne TDA realizohet nga pedagoget efektive te UAL.
4. Ne institucion ruhet lista e stafit akademik qe meret me zbatimin e programit te studimit, dosjet personale dhe dokumentacioni i stafit akademik dhe ndihmes te cilat rifreskohen e pasurohen periodikisht. Te dhenat qe lidhen me stafin ruhen ne menyre konfidenciale.
5. Detyrat e stafit jane te percaktuara qarte ne pershkrimin e vendit te punes. Pedagoget e rekrutuar qe udheheqin punimet e Diplomes jane te gjithë me tituj e grada shkencore .

4. Infrastruktura në funksion të programit të studimit, logjistika dhe shërbime të tjera ndaj komunitetit

Terma reference: mjediset, infrastruktura, teknologjitë e informacionit, biblioteka, shërbime të tjera për studentët, residencat.

UA ka ne dispozicion te procesit mesimor, formimit shkencor dhe sherbimit qe kryen ndaj klienteve dy kampuse:

1. Kampusi Laboratorik;
2. Kampusi Qendror;

Ne dispozicion te studenteve qe ndjekin studimet ne Fakultetin e shkencave Dentare jane disa mjedise me siperfaqe totale prej 3600 m². Ne kete sipefaqe perfshihen salla leksionesh me kapacitet 30-80 studente, laboratore te paisur me aparatura e bazen e duhur materiale, zyra per stafin dhe qeverine studentore, biblioteke, kafe, parking etj. UA eshte pajisur me lejen e ndertimit Nr 963/9 port, date 19.09.2018 per ndertimin e kampusit universitar me nje siperfaqe te pergjithshme 10.000m².

Sipas te dhenave te paraqitura e te verifikuara edhe ne vend, rezulton UA ka ne dispozicion te procesit mesimor edukativ e shkencor nje siperfaqe te pergjithshme qe realizon nje raport 9.4 m² per cdo student dhe 17m² per cdo antar te stafit mesimor e administartiv.

Labororet ne funksion te mesimit dhe aktivitetit klinik qe ndjekin programet e studimit ne Fakultetin e Shkencave Dentare jane:

- Laboratori i Morfologjise Dentare
- Laboratori i Anatomise dhe i Histologjise
- Laboratori i Dentistrise Paraklinike
- Laboratori i Dentistrise Restorative dhe Endodontise
- Laboratori i Kirurgjise dhe i Implantologjise
- Laboratori i Protetikes Fikse
- Laboratori i Ortodontise Paraklinike
- Laboratori i Protetikes se Levizeshme
- Laboratoti i Informatikes

Te gjitha keto mjedise mesimore e sherbimi, sallat e leksioneve e labororet jane me ndricim natyral dhe artificial te mjaftueshem, me dritare si dhe me ajer te kondicionuar e kushte optimale.

Gjate verifikimit ne teren u konstatua se ambjentet ishin te mireorganizuara, te mirmbajtura si nga personeli ashtu dhe nga studentet, ne gjendje optimale per te zhvilluar leksione dhe praktika mesimore e kerkimore. Lidhur me organizimin dhe siperfaqet e paraqitura nga Institucioni nuk u vrejten raste ndryshe. Te dhenat e raportura jane korekte dhe reale.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.5 - Institucioni siguron infrastrukturën e nevojshme për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë që ofron.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ka një vendndodhje të përhershme, që nënkupton mjedis qendror administrativ dhe mjedis ku zhvillohet veprimtaria mësimore;</p> <p>Kriteri 2 Këto mjedise janë në dispozicion të institucionit për jo më pak se 6 vjet;</p> <p>Kriteri 3 Nëse programi i studimit ofrohet në më shumë se një godinë, institucioni siguron</p>	<p>Universiteti ALDENT ka vendndodhje te perhershme ne Qender te Tiranes prej 15 vitesh dhe eshte lehtesisht i arritshem nga stafi dhe studentet apo te interesuarit.</p> <p>Keto mjedise jane ne dispozion te institucionit qe kur ai ka filluar aktivitetin e tij ne vitin 2003, pra per nje periudhe prej mbi 15 vjet. Ne planet e Institucionit eshte edhe ndertimi i nje kampusi te ri universitar me</p>

menaxhim efikas dhe kontroll të vazhdueshëm për arritjen e standardeve dhe zbatimin e politikave arsimore të hartuara për realizimin e programeve të studimeve që ofron;

Kriteri 4 Institucioni garanton kapacitete dhe mjedise të mjaftueshme për realizimin e praktikave profesionale të parashikuara për realizimin e programeve të studimeve në fushat e shëndetësisë, veterinarisë, bujqësisë, shkencave teknike, etj.

siperfaqe prej 10.000 m² ne periferi te qytetit, por lehtesisht te aksesueshem nga te gjithë. Pas marjes se lejes se ndertimit aty vazhdon intensivisht puna. Kjo eshte nje garanci e mire per te ardhmen dhe ecurine e ketij Univesiteti. Programi i studimit Mp ne Teknologji Dentare e Avancuar zhvillohet ne dy godina moderne, shume prane njera tjetres ne qender te qytetit Tirane. Kjo i krijon mundesine Institucionit dhe strukturave drejtuese te tij qe te menaxhoje e kontrolloje lehtesisht punen qe kryhet dhe aktivitetin e sejcilit ne zbatim te programit studimor.

UA ka siguruar kapacitete dhe mjedise te mjaftueshme per realizimin e leksioneve dhe te praktikave profesionale te parashikuara ne planin mesimor te ketij studimi ne fushen e teknikave te protezimit te dhembeve. Mjediset jane te bollshme edhe per kryerjen e sherbimeve ndaj pacienteve, veçanerisht te atyre ne nevojë. Kapacitete dhe mjediset ne dispozicion ne UAL mundesojne edhe veprimtari studimore shkencore per stafin dhe studentet dhe ne kete drejtim ka patur rezultate pozitive.

Standardi V. 1- Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën e tij.

Kriteri 1 Institucioni siguron tekste mësimore cilësore dhe literaturë ndihmëse të mjaftueshme dhe bashkëkohore;

Kriteri 2 Në bibliotekë ka literaturë të mjaftueshme që e ndihmon studentin për për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës;

Kriteri 3 Në bibliotekë ka botime periodike dhe librari elektronike, të cilat përmbajnë libra apo revista shkencore të nevojshme për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës;

Kriteri 4 Përgjegjësit e programit kanë hartuar një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës nga studentët, përfshirë edhe buxhetin e planifikuar për këtë qëllim;

Kriteri 5 Biblioteka ka orare të shërbimit në përshtatje me oraret e programeve të studimeve dhe nevojat e studentëve.

Ne funksion te programit te studimit UA ka siguruar tekste mesimore dhe literature ndihmese ne menyre te mjaftueshme ne gjuhen shqipe dhe ne gjuhe te huaj per realizimin me sukses te programit te ofruar. Pedagoget e lendeve bejne perpjekje per pasurimin e rinovimn ne menyre te vazhduar te literatures per kete program. Gjate vizites ne biblioteken e UA u konstatua nje fond i konsiderueshem librash, tekste baze, qe u sherbejne studenteve ne programin e studimit. Ka gjithashtu literature specifike per programin e studimit MP ne Teknologji Dentare te Avancuar si gjate procesit mesimor ashtu edhe per tu thelluar ne çeshtje te veçanta apo per kerkim shkencor.

Literatura e lendeve profesionale ne sherbim te programit te studimit MP ne Teknologji Dentare te Avancuar eshte me e bollshme ne gjuhe te huaj.

Mungojne librat ne gjuhen shqipe per laborantet dentare.

Biblioteka e Universitetit Aldent ishte e abonuar edhe ne disa revista periodike me karakter mjeksor te fushes se stomatologjise e te protezimit te dhembeve.

	<p>Biblioteka pasurohej ne menyre te vazhdueshme me revista shkencore e libra te shtepive botuese Elsevier, Masson etj. Ky fond eshte i aksesueshem e ne perdorim te studenteve per qellime mesimore qe i perkasin ketij programi studimi apo dhe per thellimin e metejshej te njohurive te tyre profesionale e shkencore.</p> <p>Organizatoret e programit te studimit kane siguruar literaturen e nevojshme sipas planit mesimor te aprovuar. Ne Biblioteken e UA funksionon dhe eshte ne dispozicion te studenteve dhe te stafit akademik edhe Biblioteka online Hinari e cila krijon nje game te gjere mundesishe dhe mund te shfrytezohet nga te gjithet.</p> <p>Biblioteka e Universitetit ADENT ka orare te pershtateshme dhe eshte ne dispozicion te studenteve te ketij programi dhe te gjithe studenteve te tjere. Ka kushte optimale pune, ndriçim e ajrosje dhe ajer te kondicionuar. Biblioteka eshte e aksesueshme dhe perdoret me efikasitet.</p>
--	--

Standardi V. 2- Institucioni vë në dispozicion të studentëve laboratorë të mjaftueshëm dhe mjedise të përshtatshme mësimore.

<p>Kriteri 1 Institucioni dëshmon se ka në sasi të mjaftueshme: laboratorë, klasa, zyra, studio e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e programit të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Pajisjet e mjediseve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit;</p> <p>Kriteri 3 Laboratorët përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të programeve të studimeve dhe për zhvillimin e praktikave të parashikuara nga programi i studimit, në përputhje me qëllimet e programit, si dhe mirëmbahen dhe janë në përmirësim të vazhdueshëm;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni, në varësi të programeve të studimeve që ofron, ka së paku një laborator, për secilin grup leksionesh ku parashikohen praktika laboratorike.</p>	<p>Konstatimi i GVJ është se mjediset aktuale janë të përshatshme dhe me hapësira funksionale për zhvillimin e të gjitha veprimtarive universitare.</p> <p>UAL ka ne sasi te mjaftueshme mjedise per zhvillimin e mesimit dhe te praktikave profesionale sipa planit mesimor te programit, si salla leksionesh, laboratore, zyra e auditore te paisura me paisje elektronike e te teknologjise se informacionit.</p> <p>Te gjitha sallat e leksioneve dhe te seminareve jane te ndriçuara mire dhe te paisura me video prjektore dhe pajisje te tjera qe mundesojne zhvillimin normal te mesimit.</p> <p>Labororet ne UA jane te paisur me insturmentat dhe aparaturat e nevojshme sipas qellimit per te cilin jane planifikuar te sherbejne ne funksion te realizimit te programit. Paisjet jane te mirembajtura dhe ne gjendje funksionale te plote, mirembahen e u sherbehet rregullisht dhe rinovohen e zevendesohen shpesh me paisje te reja sipas nevojave te programit qe zhvillohet, por edhe ritmeve te zhvillimit e perparimit teknologjik ne kete fushe.</p> <p>Te gjitha ambientet si per pjesen teorike, ashtu edhe per zhvillimin e asaj qe lidhet me praktikat profesionale apo ne sherbim te te semureve, jane ne kushte te mira</p>
--	--

	<p>higjenike dhe te paisura me sistem te ajrit te kondicionuar.</p> <p>Numri i laboratoreve dhe siperfaqet e vena ne shfrytezim per zhvillimin e programit Mp ne Teknologji Dentare e Avancuar jane te mjaftueshem, te mire paisur dhe ne gjendje te mire fizike per realizimin e tij. Institucioni e ka te zgjidhur sistemin e furnizimit pa nderprerje te energjise elektrike dhe te mbrojtjes kundra zjarrit. Eshte i paisur ne nyje hidrosanitare per personelin dhe per studentet ne sasi te mjaftueshme dhe ne kushte optimale higjenike.</p>
<p><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Mjediset aktuale janë të përshtatshme dhe kane siguruar infrastrukturen e nevojshme per zhvillimin e mesimit dhe realizimin e programit te studimit. Ambjentet per zhvillimin e mesimit dhe te praktikave profesionale jane me sasi dhe siperfaqe optimale. 2. Labororet ne dipozicion te ketij programi jane ne sasi te mjaftueshme dhe kane llojshmerine e duhur sipas lendeve e profilit te protezave qe kryhen. Ata jane te paisur teresisht sipas qellimit per te cilin e jane ngritur e perdoren. Paisja dhe infrastruktura, aparaturat dhe veglat ne dispozicion te ketij programi studimi jane bashkekohore. Ato mirembahen dhe rinovohen vazhdimisht sipas nevojave te ketij programi dhe misionit te Universitetit 3. Literatura e lendeve profesionale ne sherbim te programit te studimit MP ne Teknologji Dentare te Avancuar eshte me e bollshme ne gjuhe te huaj. <i>Mungojne librat ne gjuhen shqipe per laborantet dentare.</i> 	


5. Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare

Terma reference: burimet e financimit, kostoja për student, kapacitetet menaxhuese.

Universiteti ALDENT eshte nje institucion jopublik i Arsimit te larte dhe si i tille ai nuk financohet nga shteti. Burimi kryesor i financimit te tij jane burimet e brendshme te financimit. Konstatohet se te ardhurat ne vite kane ardhur duke u rritur, kjo si pasoje e rritjes se numrit te studenteve dhe e konsolidimit te ketij Universiteti, ndersa tarifat e studenteve jane mbajtur te pa ndryshuara dhe jane nga me konkruuesest ne treg. Kjo nuk i ka cenuar kushtet e mesimdhënjes, ato jane nder me cilesoret ne vendin tone. infrastruktura, baza materiale, auditoret, labororet, biblioteka jane permiresuar e rritur vazhdimisht. Kjo ka çuar qe edhe pse numri i studenteve nga viti ne vit eshte rritur, siperfaqja ne dispozicion per nje student te rritet vazhdimisht. Ne vitin 2014 siperfaqja per 1 student u rrit nga 4 m² ne 8 m²/student, pra u dyfishua, sot eshte 9.4m² /student. Eshte shtuar ne menyre ritmike numri i stafit akademik, sidomos i atyre me tituj e grada shkencore ku institucioni ka nje politike te caktuar e te qarte. Ka patur shtesa progresive te ndjeshme te librave ne biblioteke, te numrit te PC., video projekteve, informatizimi, biblioteka online etj. Te gjitha keto kane krijuar disa lehtesira.

Studentet kane disa perfitime dhe nuk paguajne kosto shtese veç tarifes se studimit. Nuk paguajne per:

- Ridhenie te provimeve dhe perseritjen e vitit shkollor (per 1 vit);




- Per paisjen me dokumenta si vertetime, transferime, çregjistrime, diplome;
- Per pagesa jashte afatit te kontrates, per praktika mesimore dhe ekspedita jashte Tiranes;
- Transporti nga Qendra e Tirane per ne Kampusin Qendror eshte falas;
- Aktivitetet kulturore dhe sportive qe organizohen nga shkolla;
- Aktivitetet shkencore si Summer school, Winter school etj;

Institucioni financon per veprimtari shkencore si per ato qe organizon vete universiteti, por edhe per veprimtari te organizuara nga shoqata te ndryshme mjeksore e dentare. Universiteti çdo vit ka te percaktuar nje fond te veçante per organizimin e konferencave shkencore dhe trajnimeve nga profesore dhe specialiste te huaj te mjeksise e te Stomatologjise. Gjithashtu institucioni ka kryer edhe donacione te dobishme e me karakter humanitar si sponsorizimi per rikonstruksionin e pavionit te Fizioterapise prane QSUT, rikonstruksioni i çerdhes nr.23 ne Tirane, donacion per shkollen “Adem Alushi” ne Tepelene si dhe donacione te ndryshme ne raste fatkeqesise natyrore, per femijet jetime e raste te tjera

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.9 - Institucioni bën një auditim të përvitshëm (të jashtëm dhe/ose të brendshëm) të situatës financiare.	
<p>Kriteri 1 Raporti i auditit paraqet të gjithë situatën financiare për përdorimin e buxhetit të vënë në dispozicion për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;</p> <p>Kriteri 2 Raporti i auditit përmban një pasqyrë të qartë të granteve të huaja të përfituara dhe kontratave të shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;</p> <p>Kriteri 3 Raporti i auditit analizon eficiencën e përdorimit të të ardhurave nga tarifat e studentëve në funksion të rritjes së cilësisë së studimeve në këtë cikël studimesh.</p>	<p>Ne UAL hartohet çdo vit buxheti i vitit pasardhës ku planifikohen fonde edhe për programet e reja që janë projektuar për tu hapur. Kjo praktike është ndjekur edhe me buxhetin e vitit 2018 ku janë planifikuar fondet e nevojshme për programin e studimit MP në Teknologji Dentare e Avancuar. Të ardhurat e Institucionit sigurohen kryesisht nga tarifat e studenteve dhe kanë ardhur duke u rritur progresivisht nga viti në vit.</p> <p><i>Institucioni nuk ka përfituar nga grante ose financime të Bashkimit Evropian për vendet jo anetare për projekte të ndryshme në fushën e arsimit.</i></p> <p>Te ardhurat në vitin 2018, krahasuar me vitin 2014 janë rritur me 58 %, me një shtesë fizike prej 275, 577,000 leke. Shpenzimet gjithashtu janë rritur gjatë viteve 2014-2018 duke shënuar një nivel rritjeje prej 32 %.</p> <p>Me gjithë rritjen e numrit të studenteve, kostoja për student është rritur vazhdimisht dhe në vitin 2018 është 10% më e lartë. Po kështu ka shënuar rritje të konsiderueshme edhe zeri i investimeve dhe në vitet 2018 e 2019 është investuar për ndertimin e një korpusi universitar bashkëkohor me sipërfaqe të</p>

1. UA ka gjendje te qendrueshme ekonomike e financiare, perballon me burimet e Institucionit shpenzimet per zhvillimin e programeve te studimit qe ka organizuar , ne kete kuader edhe te programit MP ne Teknologji Dentare te Avancuar.
2. Situata financiare e Institucionit ka shenuar rritje te vazhdueshme nga viti ne vit, po keshtu jane rritur edhe shpenzimet per permiresimin e kushteve te mesimit, sherbimit dhe kerkimit shkencor. Konsolidimi ekonomik i Institucionit ka sjelle ne menyre ritmike permiresimin e infrastruktures se mesimit e kerkimit per sot dhe rritjen e investimeve per te ardhmen.
3. *Akses i kufizuar ne grante dhe financime te BE per shtetet jo anetare .*

6. Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë

Terma reference: institucionalizimi i sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë, ngritja e Njesisë së SBC, funksionimi i saj, vetëvlerësimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë, rezultatet e vlerësimeve të jashtme.

Institucionet e arsimit të lartë sipas Ligjit të Arsimit të Lartë Nr 80, datë 22.7.2015 janë përgjegjëse për sigurimin e brendshëm të cilësisë dhe ngrenë njësinë përkatëse të sigurimit të brendshëm të cilësisë. Ekzistenca e kësaj strukture është e paraqitur në Statut, Rregulloren e Brendshme të Universitetit Aldent, si dhe ne Rregulloren e vetë njësisë së SBC. Kjo strukture ka si qellim vlerësimin dhe monitorimin periodik te cilësisë te programeve mësimore, stafit akademik, administrativ dhe ndihmës, studentëve, mësimedhënies, shërbimeve të logjistikës dhe shërbimeve të tjera që Universiteti ofron. Ne vizitën në institucion, GVJ u takua me anëtarët e njësise. Kjo Njesei perbehej nga 5 anetare:

1. Klodiola Dhamo Kryetare;
2. Ajola Nasti Anëtar;
3. Mirva Hoxha Anëtar;
4. Entela Haloci (Ekspert i Jashtëm)
5. Irian Lubonja (Përfaqësues i Unionit Studentor)

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Të dhëna sasiore për punën konkrete në NJSBC për programin e studimit, si:
 - Sa anketime kanë bërë me studentët
 - Sa studentë janë anketuar
 - Sa prej tyre janë përpunuar dhe çfarë problemesh kanë dalë
 - Cilat kanë qenë hapat e mëtejshëm

GVJ u njoh nga NJSBC me metodologjinë e ndjekur për monitorimin dhe vlerësimin periodik te veprimtarise mesimore dhe kerkimore shkencore te institucionit ne pergjithesi dhe programit Master Profesional Teknologji Dentare e Avancuar ne vecanti.

Institucioni kryen anketime me studentët në mënyrë të vazhdueshme çdo vit akademik, para sezonit të provimeve. Të gjitha anketimet përpunohen çdo vit akademik dhe problematikat e dala i raportohen senatit akademik, me qëllim përmirësimin e treguesve të dobët. Mbi këto rezultate hartohen politikat e

shfrytezueshme rreth 10000 m².

Auditi i zhvilluar çdo vit ne institucion ka konstatuar gjendjen reale te biznesit. Lidhur me programin e studimit, institucioni ka bere planifikimin e nevojshem me fondet e veta. Nuk eshte marre asnje grand i huaj apo burime financimi nga jashte institucionit. Duke qene se ky eshte kontigjenti i pare i studenteve qe studiojne ne programin MP ne Teknologji Dentare e Avancuar gjate vitit akademik 2018-2019, ata jane kryesisht punonjes te tij. UA ka ndjekur nje politike favorizuese lidhur me tarifat e studenteve. Shpenzimet per programin ne fjale qe jane te konsiderueshme po shfrytezohen gjate ketij viti, por do te sherbejne edhe per brezat e studenteve qe do te vijne ne te ardhmen. Nje shpenzim i konsiderueshem eshte edhe blerja e venja ne perdorim e sitemit te kompjuterizuar CAD_CAM qe perdoret per dizenjimin dhe pergatitjen e protezave dhe qe eshte pjese e ketij programi. Te gjitha keto Institucioni i ka perballuar me financimet e veta.

Standardi VI.1 - Institucioni harton një raport financiar të kostove të programeve të studimeve.

Kriteri 1 Institucioni harton një raport që pasqyron të dhëna të hollësishme financiare të kostove për realizimin e programeve të studimeve, si kostot operacionale, kostot fikse të mjediseve dhe të pajisjeve, etj.

Kriteri 2 Institucioni dëshmon se ka një qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programeve të studimeve dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave në të ardhmen.

Institucioni harton raporte te veçanta me te dhena te hollësishme per kostot e programeve qe ka organizuar, ne kete kuader edhe per programin MP ne Teknologji Dentare e Avancuar. Investimi fillestar lidhur me kostot ne kete program eshte i konsiderueshem, por mendohet se ai do te sherbeje per vijushmerine e tij ne te ardhmen.

Universiteti Aldent ka nje rritje progresive te dukshme dhe qendrueshmeri financiare te plote per zhvillimin e programeve te studimeve qe ka ofruar. Situata financiare e tij eshte e shendetshme.

Ky institucion paguan rregullisht e ne afate detyrimet ndaj shtetit. Eshte praktike per tu vleresuar fakti qe pasi ka bere kryerjen e te gjithë shpenzimeve te nevojshme, te ardhurat e mbetura shkojne kryesisht per investime e permiresime te infrastrukturës, objekteve dhe te kushteve te mesimit, sherbimit dhe kerkimit shkencor. Duke ecur hap pas hapi ka shenuar nje rritje graduale e te qendrueshme.

Konkluzionet e vlerësimit:

përmirësimin për çdo problem hap pas hapi. Të gjitha rezultatet janë paraqitur në raporte vjetore vetëvlerësimi dhe i janë raportuar Senatit Akademik.

Per programin Master Profesional ne Teknologji Dentare e Avancuar ishte realizuar dhe perpunuar anketimi per semestrin e pare perpara sezonit te provimeve ne muajin shkurt. GVJ u njoh me pyetesorin e mesimdhenies dhe mesimnxenies. Ky pyetesor ishte organizuar per here te pare duke perdorur metodologjine standarte te zhvillimit te sondazheve me ndihmen e platformave on line, Limesurvey dhe Survey Monkey duke perdorur llogari te personalizuara per cdo student. Ne anketim kishin marre pjese 9 studente.

Te dhenat e siguruar nga pyetesori ishin perpunuar dhe hedhur ne raportin analitik qe na u vu ne dispozicion gjate vizites ne institucion. Përgjegjësitë në monitorimin dhe menaxhimin e cilësisë janë deri në nivel departamenti. Çdo anëtar i grupit vjetor të punës për njësinë e SBC përfaqëson njësinë strukturore të cilës i përket, qoftë mësimore apo administrative, dhe merr informacionin bazë të auditimit të kësaj strukture. Të gjitha problematikat dhe rezultatet diskutohen në mbledhjet periodike të grupit.

Vetëvlerësimet e kryera dhe rezultatet e tyre

Nga vizita në institucion u konstatua se Departamenti bën një analizë pune për procesin mësimor. Pas kësaj analize hartohet një raport që i paraqitet Rektorit. Kishte një formular vlerësimi për pedagogët në kuadër të rritjes së kualifikimit të tyre. Organizoheshin anketimet me studentët dy herë në vit.

Politikat e përmirësimin të cilësisë mbi bazën e vetëvlerësimeve periodike

Institucioni trajtonte me kujdes cdo problem qe raportohet nga auditimet e NJSBC, stafit akademik ndihmes mesimor dhe administrativ, hallkat drejtuese duke marre masa per zgjidhjen e tyre.

Problematikat e hasura nga auditimet dhe nga pyetësorët e mesimdhenies dhe të mesimnxënies i transmetohen nga njësia e SBC Rektorit i cili ja komunikon edhe burimeve njerëzore te cilat mbajne shënime mbi performancën e stafit. Vendimet mbi hapat që do të merren për përmirësim të problematikave diskutohen në senat rast pas rasti. Të gjithë anëtarët e grupeve vjetore të punës së njësisë së SBC janë pedagogë të brendshëm dhe përfaqësues të departamenteve të rëndësishëm administrative të universitetit të cilët janë në kontakt të drejtëpërdrejtë me mesimdhënien dhe problemet e lidhura me të. Çdo fakultet përfaqësohet nga një pedagog në njësinë e SBC, kështu që komunikimi i problematikës dhe detyrave nga njësia në fakultet dhe anasjelltas realizohet me sukses.

Nga vizita në institucion, takimin me NJSBC, GVJ konstaton se nuk ka ndryshime nga të dhenat e deklaruara nga Institucioni në Raportin e Vlerësimit të Brendshëm (RVB) për këta tregues.

Të dhëna sasiore për punën konkrete në NJSBC për programin e studimit, si:

- **Sa anketime kanë bërë me studentët;**

Institucioni kryen anketime dy here ne vit perpara sezoneve te provimeve.

- **Sa studentë janë anketuar;**

Per kete program studimi kishin marre pjese 9 studente.

- **Sa prej tyre janë përpunuar dhe çfarë problemesh kanë dale;**

Te gjitha anketimet perpunohen, dhe problematikat e dala I raportohen Senatit Akademik me qellim permisimin e pikave te dobeta.

• **Kontrolli i brendshëm i cilësisë**

UA ka njësinë për sigurimin e brendshëm të cilësisë, e cila përcakton edhe strategjinë dhe procedurat që ndiqen për sigurimin e cilësisë. NJSBC ndjek të gjitha proceset e vlerësimit institucional por edhe të programeve të studimit. Bashkepunon me të gjitha instancat e institucionit me qëllim ruajtjen dhe permisimin e cilësisë. Mbi këto rezultate hartohen politikat e permisimit për çdo problem. Të gjitha rezultatet paraqiten në raportet vjetore të vetvlerësimit ku i përcillen edhe senatit akademik.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi I.10 - Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni e përfshin këtë informacion në vetvlerësimin që bën për arritjen e sigurimit të brendshëm të cilësisë;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni publikon rezultatet e vlerësimit dhe rezultatet që synon të arrijë;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni, për kryerjen e vlerësimit, përdor metoda të tërthorta ose të drejtëpërdrejta.</p> <p><u>Të tërthorta:</u></p> <p>Sondazhe: të studentëve që ndjekin programet e studimeve, të të diplomuarve në këto programe në vitet e mëparshme akademike apo në ciklet e ndryshme të studimeve;</p> <p>Sondazhe të vlerësimit të mësimdhënies, kurrikulës, të të mësuarit;</p> <p>Pyetje konceptuale;</p> <p>Intervista;</p> <p>Etj.</p> <p><u>Të drejtëpërdrejta:</u></p> <p>Rezultatet e arritura nga studentët në teste të standardizuara kombëtare/ndërkombëtare (p.sh. provimi i shtetit për profesionet e rregulluara, etj);</p> <p>Dëgjime në auditor;</p> <p>Rezultatet e arritura nga studentët në provimet e vlerësuara me nota/pikë;</p> <p>Rezultatet e arritura nga studentët në testimet</p>	<p>Institucioni ka njësinë e SBC e cila monitoron në mënyrë të vazhdueshme sigurimin e cilësisë duke përdorur metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programit të studimit. Këto informacione janë të përfshira në vetvlerësimin institucional. Keto informacione janë transparente duke i publikuar ato në WEB.</p> <p>Institucioni përdor për vlerësimin metoda të tërthorta dhe ose të drejtëpërdrejta.</p> <p><u>Metodat e tërthorta:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> • Sondazhe me anë të pyetësorëve on line të studentëve, ku ata shprehen në kushte anonimiteti për mesimdhënien, kurikulen, vlerësimin dhe transparencën në vlerësim, performancën e Institucionit etj. • Sistemi i Tutorëve/Kujdestarëve të Grupeve të studentëve, siguron komunikim të drejtëpërdrejtë me studentet për të gjitha aspektet e procesit arsimor. <p><u>Të drejtëpërdrejta</u></p> <ul style="list-style-type: none"> • Informacionet të lidhura me rezultatet e studentëve në teste të standartizuara kombëtare (provime shteti për licencim etj) merren nga Institucionet përkatëse. • Staf i akademik komunikon vazhdimisht me studentët në diskutime të hapura për të shprehur lirshëm çështje dhe problematika që lidhen me procesin mesimor. • Vlerësimi i studentëve bëhet sipas formave të përcaktuara ligjore të cilat janë pjesë e Statutit, Rregullores së Universitetit dhe Programit të studimit.

<p>paraprake dhe përfundimtare, provimet për module, praktikat profesionale;</p> <p>Rezultatet e arritura nga studentët në vlerësimin e detyrave të kryera gjatë zhvillimit të programit të studimit (punë individuale apo në grup, detyra kursi për të analizuar të kuptuarit konceptual, referatat, projektet, provimet, etj.);</p> <p>Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës;</p> <p>Rezultatet e arritura dhe cilësia e rezultatit të kërkimit - tezës;</p> <p>Etj.</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Këto vlerësime dokumentohen në formën e proces-verbaleve të cilat janë në përputhje me legjislacionin. • Të gjithë studentët gjatë kryerjes së Praktikave Laboratorike mbikqyren nga përgjegjësit e caktuar. • Rezultatet e arritura dhe cilësia e Tezës, janë në fokusin e vlerësimit .
<p>Standardi I.13 - Institucioni publikon rregullisht informacion të paanshëm dhe objektiv, sasior e cilësor, për vlerësimin e brendshëm.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni publikon rregullisht broshura, buletine etj., të hartuara dhe botuara nga institucioni, për vlerësimin e brendshëm;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni publikon rregullisht prezantime në faqe interneti, video e audio etj. për vlerësimin e brendshëm.</p>	<p>Çdo vit NJSBC e Universitetit “Aldent” harton një raport vjetor mbështetur në të dhënat e mbledhura dhe përpunuara nga anetaret e NJSBC-së.</p> <p>Ky raport hidhet në WEB-in e Universitetit.</p>
<p>Standardi II.7 - Institucioni kryen një analizë vjetore për vlerësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni harton një analizë vjetore për vlerësimin e ecurisë së programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni harton politika që synojnë përmirësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë.</p>	<p>Çdo vit institucioni harton një analizë vjetore mbështetur në raportin e NJSBC-së për ecurinë e programit të studimit.</p> <p>Mbështetur në këto rezultate, institucioni harton politika që synojnë përmirësimin e vazhdueshëm të programeve të studimit.</p>
<p>Standardi VIII.1 - Institucioni garanton sigurimin e cilësisë në realizimin e programeve të studimeve.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional përpara aplikimit për akreditimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni harton një politikë dhe ndjek procedura të caktuara për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të tyre;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni përdor mekanizma formale për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimit;</p> <p>Kriteri 5 Institucioni synon ndërgjegjësimin e</p>	<p>Universiteti “Aldent” është akredituar në nivel institucional Urdhëri i MAS Nr 111 datë 11/03/2016.</p> <p>Në kuadër të akreditimeve që IAL-te bën me Agjencine Britanike të Akreditimit QAA Universiteti Aldent u vlerësua me riakreditim me vlefshmëri deri në vitin 2022 me vendim Nr114 datë 15.12.2017 nga ASCAL.</p> <p>Ky institucion përdor NJSBC për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë të programeve që ofron. Kjo njësi kryen një vlerësim periodik të cilësisë së programeve duke përdorur instrumentat e duhura për sigurimin e cilësisë.</p>

<p>personelit të vet dhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve që ofrohen, për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë në to;</p> <p>Kriteri 6 Institucioni harton dhe zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Strategjia, politika dhe procedurat janë publikuar.</p>	<p>Rregullorja e Përgjithshme e Universitetit Aldent , statuti neni 13, “Për organizimin e punës për kontrollin e brendshëm” është në përputhje me normat ligjore në fuqi. Institucioni ka të përcaktuar procedurat për njohjen me standartet e cilësisë dhe shpjegimit të rëndësisë së tyre.</p> <p>NJSBC punon në mënyrë të vazhdueshme me personelin dhe studentet duke synuar njohjen e tyre me standartet e cilësisë, rëndësinë që ato kanë.</p> <p>UA në bashkëpunim me NJSBC harton, zbaton dhe publikon strategjitë që lidhen me përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë.</p>
<p><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Institucioni është i angazhuar në sigurimin e vazhdueshëm të cilësisë së programit të studimit; 2. Të dhënat e siguruar nga NJSBC për problematika të caktuara që lidhen me programin e studimit analizohen me seriozitet nga institucioni duke marrë masa për zgjidhjen e tyre; 3. Të dhënat e siguruar nga NJSBC me anë të metodave të drejtpërdrejta dhe të tërthorta i shërbejnë institucionit për të hartuar dhe zbatuar strategji të reja për përmirësimin e cilësisë. 	

POLITIKAT E FORMIMIT TË STUDENTËVE

7. Programi i studimit, organizimi i tij

Terma reference: misioni dhe objektivi i programit të studimit, përmbajtja e programit, organizimi i vitit mësimor, semestrat, plani mësimor me të gjithë elementët e tij (lëndët/modulet, kreditet përkatëse, ndarja e orëve për çdo kredit në varësi të formave të studimit, orët mësimore përkatësisht në auditor/jashtë auditorit të ndara sipas formave të mësimdhënies), literatura dhe materiale të tjera mbështetëse e ndihmëse, etj

Misioni i programit të studimit Master Profesional në “Teknologji Dentare e Avancuar” është të përgatisë teknike laborante dentar me formim të larte teorik – praktik, të aftë që të përballojnë kërkesat gjithmonë në rritje të shërbimit stomatologjik .

Institucioni është i angazhuar në krijimin e kushteve optimale me qëllim që studentet:

- të zotërojnë sa më shumë metoda dhe teknologji moderne të protezimit dentar;
- të marrin njohuritë e duhura në fusha ku zhvillimet e reja në stomatologji po ecin me shpejtesi si: protezat biofunktionale, implantologjia, ortodoncia etj;
- të kenë formim dhe etike profesionale, përkushtim të larte për punën;
- të jenë të aftë të orientohen në mjedisin ku do të punojnë, duke koordinuar aftësitë profesionale dhe ato menaxheriale;
- të jenë të aftë t’i përgjigjen kërkesave të larta estetike dhe funksionale që kërkohen sot;

Keto objektiva synohen te realizohen ne perfundim te programit Master Profesional "Teknologji Dentare e Avancuar".

Programi i studimit Master Profesional në "Teknologji Dentare e Avancuar", është organizuar në 2 semestra, ku të gjitha modulet janë semestrale. 1 ECTS është e barazvlefshme me 25 orë mësimore punë të studentit dhe 1 orë mësimore zhvillohet në 50 minuta. Në fund të studimit 1-vjecar, studenti diplomohet me titullin: " Master Profesional" në "Teknologji Dentare e Avancuar". Literatura për cdo lëndë të programit të studimit Master Profesional në "Teknologji Dentare e Avancuar" përzgjidhet nga pedagogu përgjegjës i lëndës dhe miratohet nga përgjegjësi i departamentit.

Si literaturë përdoren:

- Tekste plotësuese në gjuhën shqipe ose në gjuhë të huaj të përshtatshme për t'u përdorur nga studentet;
- Tekste (botime) të hartuara nga vetë pedagogët e Fakultetit;
- Leksione te shtypura;
- Rekomandimi i literaturës behet nga ana e pedagogut;

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Viti i fillimit, qëllimet dhe objektivat e çdo programi studimi

Me Urdhër Nr. 190 datë 20.04.2018 të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë është licensuar programi i studimit të ciklit të dytë "Master Profesional ne Teknologji Dentare e Avancuar". Ky program është hapur për herë të parë në vitin akademik 2018-2019, me kohëzgjatje 1 vit akademik (60 kredite), në sistemin e studimeve me kohë të plotë. Ne fillim te vitit akademik 2018-2019 ne kete program studimi jane regjidtruar 11 studente, por per arsyet e tyre dy nga keta i kane nderprere studimet dhe tani vijojne regullisht 9 studente. Qellimi i programit është të përgatisë teknike laborante dentar me formim të larte teorik – praktik, të aftë që të përballojnë kërkesat gjithmonë në rritje të shërbimit stomatologjik .



Organizimi i programit të studimit

- 1 vit akademik ka 30 javë mësimore në auditor;
- 1 Semestër ka 15 javë mësimore në auditor;
- 1 ECTS = 25 orë mësimore punë të studentit;
- 1 orë mësimore = 50';

Plani mësimor sipas viteve akademike, ndarja e ECTS sipas formave të mësimdhënies për çdo lëndë

Programi i studimit realizohet me 60 ECTS, bazuar në planin mësimor të propozuar nga departamenti, me vendim të Këshillit të fakultetit dhe miratuar me vendim senati. Plani mësimor që ofron ky program studimi është në favor të thellimit të njohurive që studentet të përballojnë kërkesat gjithmonë në rritje të shërbimit stomatologjik .

Mënyra e përcaktimit të krediteve (ECTS) për format e studimit:



- Për leksionet 6 - 12 orë në auditor dhe 9-13 orë punë e pavarur e studentit;
- Për Seminaret 6 - 8 orë në auditor dhe 9-17 orë punë e pavarur e studentit;
- Për Labororet 18 - 25 orë në auditor dhe 0-7 orë punë e pavarur e studentit;
- Për Praktikën Profesionale 20-25 orë në auditor dhe 0-5 orë punë e pavarur e studentit;
- Diploma 12 ECTS 24 orë në auditor dhe 276 orë punë e pavarur e studentit

Ndryshimet në Planet mësimore, krahasuar me programet mësimore të licensuara (tabela11 ne aneks)

Ka ndryshime ne planet mesimore. Lenda “Protetike e Levizshme” e cila ne planin mesimor te programit te licencuar ishte parashikuar te zhvillohej semestrin e pare ne planin mesimor te vitit akademik 2018-2019 zhvillohet semestrin e dyte.

Disiplinat mësimore dhe veprimatritë e tjera formuese që ofrohen në këtë program studimi janë të organizuara në 6 kategori, nga A – F në zbatim të akteve nënligjore që përshkruajnë organizimin e programit. (tabela 12 ne aneks)

Planet mësimore të lidhura me personelin akademik përkatës

GVJ konstatoi se nuk ka ndryshime të gjendjes së konstatuar në institucion me të dhenat e deklaruar nga Institucioni në Raportin e Vlerësimit të Brendshëm (RVB) për këta tregues. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur në ASCAL, duke iu referuar pedagogëve të cilët mbulojnë këto lëndë në planin mësimor rezulton se: plani mësimor mbulohet nga pedagogë të brendshëm ne masen 77%.

Vlerësimi për Syllabus-et dhe elementët e tyre, për çdo lëndë.

GVJ konstatoi se cdo lende ka syllabusin perkates ku pasqyrohen keto elemente:

- Emërtimi i lëndës/modulit
- Viti/semestri kur zhvillohet lënda
- Emri i pedagogut që do të zhvillojë lëndën
- Vendi që zë lënda në formimin tërësor të studentit
- Njohuritë paraprake që duhet të ketë studenti për përvetsimin e lëndës
- Çfarë njohurish dhe aftësish i jep studentit kjo lëndë
- Temat që do të trajtojë lënda në formimin teorik dhe praktik
- Ngarkesa në orë në auditor dhe jashtë auditorit si dhe në ECTS
- Format dhe metodat e mësimdhënies të lëndës dhe raportet midis tyre
- Format e vlerësimit të studentëve
- Detyrimet e studentit për lëndën
- Literatura e detyruar dhe ajo ndihmëse

Analizë e cilësisë së syllabuseve




Syllabuset e lendeve jane te plota me gjithë informacionin e nevojshemne lidhje me : pershkrimin e lendes, kreditet, objektivat, format e mesimdhënies, menyren e vleresimit, literaturen e rekomanduar, ngarkesen ne auditor dhe jashte tij etj.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ofron programe të akredituara të studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS);</p> <p>Kriteri 2 Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek një program studimi me kohë të plotë është 60 kredite;</p>	<p>Programi Mp në Teknologji dentare e Avancuar është në proces vlerësimi në kuadër të akreditimit të parë. Në bazë të shqyrtimit të dokumentacionit përkatës arrihet në përfundimin se studimet organizohen në module dhe vlerësohen në kredite, sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe të Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p> <p>Numri i krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek programin Master Profesional në Teknologji Dentare e Avancuar është 60 ECTS .</p>
Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.	
<p>Kriteri 2 Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave”, “Master i arteve të bukura” apo “Master Profesional” i pajisin studentët që zotërojnë diplomën universitare “Bachelor” me njohuri të thelluara, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor apo trajnim të mirëfilltë profesional;</p> <p>Kriteri 3 Programet e studimeve “Master i Shkencave” ose “Master i arteve të bukura” dhe “Master Profesional” synojnë të zgjerojnë njohuritë e fituara në ciklin e parë të studimeve;</p> <p>Kriteri 4 Programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë (në mjekësi, stomatologji, farmaci, veterinari, arkitekturë) i pajisin studentët me njohuri të thelluara dhe kompetenca shkencore, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor sipas fushës. Pas përfundimit të tyre si dhe përfundimit me sukses të provimit të shtetit për programin specifik, studentët fitojnë të drejtën e ushtrimit të një</p>	<p>Programi i studimit Master Profesional ne “Teknologji Dentare e Avancuar” nuk bën përsëritje të lëndëve dhe moduleve që studentët kanë bërë në bachelor.</p> <p>Ne kete program i eshte dhene prioritet përgatitjes teorike dhe praktike profesionale me teknikat e avancuara ne fushen e protezimit dentar, implantoprotezes dhe ortodoncise.</p> <p>Kerkesat e tregut ne sherbimin dentar per teknikat e avancuara ne fushen e protetikes dentare implantoprotezes, ortodoncise vitet e fundit jane gjithmone ne rritje dhe ky program u jep mundesine studenteve tu pergjigjen ketyre kerkesave. Studenteve dhe stafit u jane mundesuar workshope profesional dhe trajnime.</p> <p>Punimet e diplomës janë të tipit praktiko- profesional duke mundësuar mbrojtjen e temës së diplomës me një prezantim konkret të punimit laboratorik protetik apo ortodontik përpara komisionit të vlerësimit.</p>

<p>profesioni të rregulluar sipas ligjit në fuqi;</p> <p>Kriteri 5 Programet e studimeve të këtij cikli i pajisin studentët me kompetenca të përgjithshme dhe profesionale që synohen të arrihen apo të zgjerohen gjatë zhvillimit të tij;</p> <p>Kriteri 6 Programet e studimeve “Master i Shkencave” ose “Master i arteve të bukura” dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë krijojnë baza të qëndrueshme njohurish për studimet e ciklit të tretë doktoratës, duke përfshirë aftësimin për kërkimin shkencor dhe plotësimin e parakushteve (njohuri, aftësi dhe kompetenca) për pranimin në ciklin e tretë të studimeve;</p> <p>Kriteri 7 Programet e studimeve “Master Profesional” kanë objektiva të qartë profesionale, të justifikueshëm, të arritshëm, me synime të qarta për arritjen e kualifikimit të nevojshëm dhe në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</p>	
---	--

Standardi I.4 - Programet e studimeve ofrohen në përshtatje me nivelin e studimeve.

<p>Kriteri 1 Përmbajtja dhe renditja e objektivave të programeve të studimeve synojnë arritjen e qëllimeve të tyre në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato;</p> <p>Kriteri 2 Metodatat e vlerësimit të studentëve nëpërmjet kontrollit të vazhdueshëm të njohurive me anë të testeve me përgjigje alternative apo provimeve përfundimtare dëshmojnë ecurinë dhe arritjet e studentëve për ciklin përkatës të studimeve.</p>	<p>Programi i studimit Master Profesional në “Teknologji Dentare e Avancuar” nëpërmjet moduleve të lëndëve synon zgjerimin dhe thellimin e njohurive teorike, dhe praktike profesionale me teknikat e avancuara në fushën e protezimit dentar, implantoprotezes dhe ortodoncise.</p> <p>Metodat e vlerësimit të studentëve janë të përcaktuara në syllabuset e lëndëve përkatëse. Studentët vlerësohen edhe nëpërmjet kontrollit të vazhdueshëm të njohurive gjatë vitit akademik, duke mundur një vlerësim sa më objektiv për arritjet dhe nivelin e tyre të dijeve konform programit të studimit Mp në “Teknologji Dentare e Avancuar”.</p>
---	---

Standardi I.5 - Programet e studimeve synojnë të arrijnë dimensione ndërkombëtare.

<p>Kriteri 1 Programet e studimeve mbështeten në përvojën disaveqare dhe praktikatat e mira të vendeve europiane;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve janë ndërkombëtarisht konkurruese për nga elementet që përmbajnë (të dhëna të përgjithshme, objektivat kryesorë, plani mësimor, kreditet, kushtet e pranimin në tometodat e vlerësimit, kriteret dhe procedurat e transferimit të krediteve e</p>	<p>Programi i studimit Master Profesional në Teknologji Dentare e Avancuar është hartuar dhe ofrohet për herë të parë në vendin tone në Universitetin Aldent. Në viziten në institucion hartuesit e tij na treguan se janë mbështetur në përvojën e universiteteve të huaja, kryesisht atyre angleze që ofrojnë të tilla programe, në përputhje me objektivat e përcaktuara në legjislacionin vendas dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara.</p> <p>Teknologjia Dentare ka pësuar një zhvillim të madh kryesisht në 10-vjeçarin e fundit, sidomos me aplikimin e</p>
--	--

<p>njohurive të fituara, diplomat që jepen në përfundim etj.) duke afirmuar vlerat e arsimit universitar në Shqipëri;</p> <p>Kriteri 3 Programet e studimeve janë hartuar në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara.</p>	<p>sistemeve CAD-CAM në Teknikën Dentare, duke sjellë kështu nevojën për të patur profesionistë Teknikë Dentarë Master të fushës, të cilët të jenë të aftë të punojnë me teknologji të avancuar.</p> <p>Per te ndjekur keto zhvillime Universiteti Aldent hartoi dhe ofroi një program të plote studimi, Master Profesional në Teknologji Dentare e Avancuar, duke mos ngelur thjesht ne trajnime dhe workshope. Ne kete program studimi janë përfshirë të gjitha disiplinat profesionale të Protetikës Dentare (përfshirë Teknika të protezimit maksilofacial dhe mbi implante), si edhe Teknika laboratorike ortodontike, për të pajisur studentet me njohuritë dhe teknikat profesionale me të reja të fushës.</p>
--	---

Standardi I.6 - Programet e studimeve përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor.

<p>Kriteri 1 Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve hartohen në përputhje me profilin e Institucionit të Arsimit të Lartë dhe strategjinë e tij për zhvillim;</p> <p>Kriteri 3 Personeli akademik angazhohet në punën kërkimore shkencore për realizimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 4 Puna kërkimore e personelit akademik të angazhuar për realizimin e programit të studimeve përkon me synimet për arritjen e qëllimeve të tij.</p>	<p>Aftësimi profesional i studentëve arrihet përmes kurrikulës që kombinon teorinë me aplikimin, me punësimin në procesin e mësimdhënies, të stafit me përvojë profesionale. Edhe programi i studimit i ciklit të dytë Master Profesional në Teknologji Dentare e Avancuar, synon aftësimin profesional me anën e orëve të shumta laboratorike e praktike, dhe përfshirjen e studentëve në praktikën profesionale e cila mundësohet falë bashkëpunimit me disa laboratorë dentarë dhe qendren e formimit dhe shërbimit klinik.</p> <p>Punimet e diplomës janë të tipit praktiko-profesional duke mundësuar mbrojtjen e temës së diplomës me një prezantim konkret të punimit laboratorik protetik ose ortodontik përpara komisionit të vlerësimit.</p>
---	--

Standardi I.7 - Programet e studimeve “Master Profesional” ofrohen në përputhje me nevojat e tregut të punës.

<p>Kriteri 1 Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master Profesional” ofrohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master Profesional” synojnë të plotësojnë nevojat në sektorët përkatës të ekonomisë vendase apo të huaj.</p>	<p>Programi i studimit Master Profesional në Teknologji Dentare e Avancuar ofrohet në përputhje me nevojat e tregut të punës .</p> <p>Vitet e fundit jane shtuar kerkesat per laborante te kualifikuar qe te njohin teknikat e avancuara ne fushen e Ortodoncise dhe Implantoprotezes .Ky program ofron nje pergatitje te larte teorike dhe profesionale me teknikat e reja laboratorike duke bere qe studentët qe do të pajisen me diplomë Master Profesional në Teknologji Dentare e Avancuar” te kene mundësi punësimi brenda dhe jashtë vendit, në laboratorë dentarë, që perdorin teknologji të avancuar, në laboratore të shërbimit protetik maksilofacial në qendra spitalore, në institucione arsimore të këtij profili.</p>
---	--

	Pranë Universitetit Aldent funksionon Zyra e Këshillimit të Karrierës e cila informon studentët për mundësitë e punësimit pas diplomimit në këtë program studimi në përputhje me kërkesat e tregut të punës.
Standardi I.8 - Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës.	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës, dhe hartohen në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni, për vlerësimin e nevojave të tregut të punës, kryen një studim tregu, i cili përfshin:</p> <p>mundësitë e punësimit të studentëve në tregun vendas ose atë rajonal, komëtar a ndërkombëtar;</p> <p>kërkesat e punëdhënësve;</p> <p>një parashikim të përafërt për numrin e pritshëm të studentëve që mund të regjistrohen në këtë program;</p> <p>numrin e të regjistruarve në programe të ngjashme në institucionet simotra.</p>	<p>Ky program studimi ofrohet duke patur parasysh nevojat e tregut të punës në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar.</p> <p>Vitet e fundit si pasojë e zhvillimeve në teknikat e reja dhe teknologjine laboratorike dentare ka patur rritje të kërkesave të mjekëve stomatologë për aftësim dhe kualifikim profesional të avancuar të laboranteve dentare .</p> <p>Në takimet në institucion me drejtuesit e tij në u njohem me faktin që ky program studimi u mbështet nisur edhe nga nevojat e brendshme të vetë Universitetit Aldent, duke i dhënë mundësinë personelit ndihmës akademik, të angazhuar në procesin mësimor në orët e praktikave laboratorike, mësimore e profesionale, të kualifikohen më tej, me synim edhe të rritjes së cilësisë së mësidhënies.</p> <p>Programi i ri i studimit Master Profesional në Teknikë Dentare të Avancuar nuk ka ekzistuar asnjëherë më parë në vendin tonë. Drejtuesit e institucionit duke patur parasysh faktin se është një program i ri studimi parashikuan një numër të pritshëm studentësh prej 10 të tillë për vit akademik.</p>
Standardi I.9 - Programet e studimeve synojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare dhe interesave kombëtare.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interes kombëtare;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve synojnë të ndihmojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare.</p>	<p>UA ofron programe studimi që janë në mbështetje të interesave kombëtare për një arsimim cilësor, me objektiv formimin e një brezi të ri intelektualësh.</p> <p>Programi Master është ndërtuar që t'i shërbejë ruajtjes së vlerave kulturore dhe interesave kombëtare, të tilla si demokracia, diversiteti, shpirti i sipërmarrjes, toleranca, bashkëpunimi, drejtësia, respektimi i të drejtave të njeriut, zhvillimi i qëndrueshëm, integrimi evropian.</p> <p>Programi i trajton, mbështet dhe i kultivon këto vlera nëpërmjet përbajtjes mësimore, kërkimit dhe veprimtarive.</p>
Standardi I.12 - Kohëzgjatja dhe numri i krediteve për programet e studimeve të këtij cikli janë në përputhje me me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.	
Kriteri 1 Programet e studimeve "Master i Shkencave" realizohet me 120 kredite europiane ECTS, ku përfshihen 30-40	N/A

<p>kredite europiane ECTS për projektin kërkimor dhe tezën që duhet përgatitur në përfundim të këtyre programeve të studimeve. Kohëzgjatja normale e tyre është 2 vite akademike;</p>	
<p>Kriteri 2 Programet e studimeve “Master Profesional” realizohen me 60-90 kredite europiane ECTS. Kohëzgjatja normale e tyre është 1-1.5 (një deri në një vit e gjysmë) vite akademike.</p>	<p>Programi i studimit “Master Profesional në Teknologji Dentare e Avancuar” realizohet me 60 kredite europiane ECTS. Kohëzgjatja normale e tij është 1 (një) vit akademik.</p>
<p>Kriteri 3 Programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përfundojnë me marrjen e diplomës “Master i Shkencave”. Ato realizohen me jo më pak se 300 kredite europiane ECTS (360 kredite europiane ECTS për studimet në fushën e mjekësisë). Kohëzgjatja normale e programeve të integruara të studimeve është jo më pak se 5 vite akademike (6 vite për studimet në fushën e mjekësisë).</p>	<p style="text-align: center;">N/A</p>
<p>Standardi II.6 - Institucioni siguron menaxhimin efikas të informacionit në lidhje me programet e studimeve.</p>	
<p>Kriteri 1 Informacioni i ofruar për programet e studimeve, modulet dhe syllabuset është lehtësisht i konsultueshem për studentët;</p> <p>Kriteri 2 Informacioni për programet e studimit, modulet dhe syllabuset ofrohet në forma të ndryshme të shkruara dhe elektronike.</p>	<p>Syllabuset e të gjitha lëndëve u vihen në dispozicion studentëve në fillim të vitit akademik. Përmes tyre ata njihen me orët në auditor, ndarjen në leksione, seminare, laboratorë dhe praktika, detyrimet që lidhen me frekuentimin dhe detyrime të tjera që lidhen me shlyerjen e lëndës sipas programit përkatës.</p> <p>Informacioni për kurrikulën publikohet në fillim të vitit akademik në faqen web,.</p>
<p>Standardi II.8 - Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë parashikojnë një plan diplomimi.</p>	
<p>Kriteri 1 Plani i diplomimit shpjegon mënyrën e diplomimit në përfundim të studimeve brenda afatit të parashikuar;</p> <p>Kriteri 2 Për realizimin e programeve të studimeve “Master i Shkencave” janë parashikuar 30-40 kredite për projektin kërkimor dhe tezën.</p>	<p>Plani mësimor dhe detajimet në lidhje me mënyrën e realizimit të tij japin informacionin e nevojshëm për mënyrën e diplomimit. Studentit, i cili ka grumbulluar 48 kredite nga programi i studimit, i lind drejta për punimin e diplomës. Punimi i diplomës është i tipit praktikoprofesional duke mundësuar mbrojtjen e temës së diplomës me një prezantim konkret të punimit laboratorik protetik</p>
<p><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Ne programin Master Profesional në Teknologji Dentare e Avancuar studimet organizohen në module dhe vlerësohen në kredite, sipas Sistemit European të Transferimit dhe të Grumbullimit të Krediteve (ECTS); 2. Ky program studimi ofrohet duke patur parasysh nevojat e tregut të punës; 	

3. Studentet njihen në fillim të çdo semestri nga titullari i lëndës me syllabusin e saj dhe ata kanë të drejtë të kenë një kopje të tij të shkruar ose në format elektronik;
4. Ky program studimi ben te mundur aftësimin profesional me anën e orëve të shumta laboratorike e praktike;

8. Mësimdhënia

Pjesa përshkrimore

Terma reference: organizimi i mësimdhënies, format e mësimdhënies, ngarkesa dhe cilësia e realizimit, kontrolli i njohurive të studentëve, metodat e mësimdhënies, teknologjitë e mësimdhënies, vlerësimi i brendshëm i mësimdhënies, aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj.

Në planin mësimor janë programuar këto forma kryesore të studimit:

Leksione. Oret teorike (leksionet) janë një nga formet kryesore të trajtimit të lëndëve. Ndjekja e leksioneve nga studentët është e detyrueshme në masën mbi 75% të orëve totale të leksioneve për lëndën përkatëse. bazuar në rregulloren e studimit të Universitetit "Aldent".

Seminare/Ushtime. Kontrolli i njohurive të përfuara nga studenti realizohet ne oret e seminareve/ushtimeve. Pjesëmarrja është e detyruar në masën 75 % të orëve totale të seminareve, që parashikohen në planin mësimor për një lëndë të caktuar.

Projekte. Studentët në fund të semestrit prezantojnë projektet që ju janë dhënë të përgatisin në lëndë të caktura. Dorëzimi i tyre është i detyrueshëm përpara provimit përfundimtar.

Praktika laboratorike. Në praktikat laboratorike studentët aftësohen profesionalisht në lidhje me njohuritë që kanë marrë. Zhvillohen gjatë gjithë vitit. Frekuentimi i tyre është i detyrueshem 100 %. Ky program studimi përfshin dhe forma të tjera të mësimdhënies si: konsultime, detyra kursi si punë e pavarur e studentëve jashtë auditorit.

Pajisjet e mjediseve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit. Të gjitha sallat, labororet, mjediset mësimore janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit. aparatura bashkëkohore dhe mjetet e nevojshme për zhvillimin e laboratoreve, praktikave klinike të parashikuara nga programi i studimit

Ngarkesa dhe cilësia e realizimit

Shpërndarja e ngarkesës mësimore është bërë konform udhëzimeve të MASR, në zbatim të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë Nr. 9741, datë 21.05.2007, i ndryshuar si dhe udhëzimet respektive të MASR.

Në kete program më shumë se 95 % e ngarkesës mësimore përballohet me staf mesimor efektiv.

Titullaret e lëndëve plotësojnë një format bazë të syllabusit të institucionit që shpërndahet nga Departamenti, në bazë të kurrikulës. Pedagogu propozon brendinë apo ndryshimet e mundshme në syllabus. Në formatin e syllabusit të secilës lëndë jane të paraqitur në mënyrë të detajuar:

qëllimi i lëndës, objektivat, bibliografia e detyrueshme, bibliografinë e rekomanduar etj.

Vlerësimi i studentit është gjithë përfshirës (semestral, vjetor). Mënyra e vlerësimit të studentëve është e përshkruar në mënyrë të detajuar në syllabusin e çdo lëndë. Nota përfundimtare bazohet mbi vlerësimin e studentit në çdo komponent të mësimdhënies: leksione, seminare, laboratore/ushtime, praktika laboratorike, projekte, si dhe provimi përfundimtar. Provimi përfundimtar zë përqindjen më të madhe të pikëve në vlerësim.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Llojet e Formave të mësimdhënies, për lëndët/modulet: (tabela 14 ne aneks)

GVJ mbështetur në vizitën në Institucion, dokumentacionin e dorëzuar konstaton se nuk ka ndryshime për këta tregues nga të dhënat në RVB.

Kurrikula permban 1500 ore nga te cilat :

- Leksione **265 ore**
- Seminare **68 ore**
- Projekte **1 ore**
- Laboratore **160 ore**
- Praktikë profesionale **114 ore**
- **892 orë** si punë e pavarur e studentit, jashtë auditorit.

Format e kontrollit të njohurive (tabela 15 ne aneks)

GVJ mbështetur në vizitën në Institucion, dokumentacionin e dorëzuar konstaton se nuk ka ndryshime për këta tregues nga të dhënat në RVB.

Aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë (tabela 16 ne aneks)

GVJ mbështetur në vizitën në Institucion, dokumentacionin e dorëzuar konstaton se nuk ka ndryshime për këta tregues nga të dhënat në RVB.

9. Studentët

Terma reference: procedurat e pranimit të studentëve, cilësia në hyrje e studentëve, numri i studentëve në hyrje dhe në dalje në vite, koha mesatare e zgjatjes së studimeve, kalueshmëria e studentëve dhe problemet që lidhen me të, statistika, punësimi i të diplomuarve, komunikimi me ish-studentët e diplomuar, informimi i studentëve.

Nga vizitat në Sekretarinë mësimore, RVB dhe dokumentacioni i DVV, GVJ konstatoi se për vitin akademik 2018 – 2019, në programin e studimit Master Profesional në “Teknologji Dentare e Avancuar”, janë të regjistruar 11 studente, 2 studente i kane nderprere studimet.

Kuotat e pranimit të studentëve në të gjitha programet e studimit ne Universitetin Aldent miratohen nga Senati Akademik .

Pranimi i studentëve në programin MP. në “Teknologji Dentare e Avancuar” është kryer në mbështetje të ligjit aktual të arsimit të lartë lartë dhe të akteve nënligjore që rrjedhin prej tij, si dhe kritereve të përcaktuar në vendimin Nr 45, datë 26.12.2017 të Senatit akademik të Universitetit “ALDENT” .

Për të ndjekur programin e studimit në programin MP. në “Teknologji Dentare e Avancuar” studenti duhet të ketë përfituar një diplomë të ciklit të parë me titullin Bachelor në Laborant Dentar.

Vlerësimi i Tregues të matshëm:

Procedurat e pranimit të studentëve

Për pranimin e studentëve është hartuar një procedurë e posacme e cila përmban: aplikimin, intervisten, rankimin dhe regjistrimin e studentëve. Në procedurë është vendosur që studentët 70% të pikëve ti marrin nga nota mesatare e bachelorit dhe 30% nga intervista me komisionin e ngritur posaçërisht për këtë qëllim. Gjatë vizitës në sekretarinë mësimore u zgjodhën në mënyrë rastësore dy dosje të studentëve.

Dokumentat e aplikimit që përbënin dosjen e pranimit ishin:

- Formulari i aplikimit;
- Formular regjistrimi;
- Dokument mbi performencën e UA;
- Kopje e noterizuar e Diplomës së Nivelit të Parë;
- Lista e notave e noterizuar;
- Kopje e kartës së identitetit;
- Mandat pagesa e tarifës;

Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve

Per vitin akademik 2018-2019 ne programin MP. në “Teknologji Dentare e Avancuar” nota mesatare hyrëse e regjistrimit është 9.01.

Studentë të regjistruar në vitin e Parë (për herë të parë). Nota Mesatare (Tabela 17 ne Aneks

Ne vitin akademik 2018-2019 ne programin MP. në “Teknologji Dentare e Avancuar” jane rregjistruar 11 studente per here te pare.,2 studente i kane nderprere studimet .Aktualisht ndjekin studimet 9 studente. Nota mesatare e regjistrimit 9.01.

Studentë të diplomuar në vitin e fundit (pa vite përsëritëse). Nota Mesatare

Nuk ka ende studente te diplomuar.

Mobiliteti i studentëve brenda sistemit të arsimit të lartë në vend

Universiteti Aldent pranon edhe studentë të cilët dëshirojnë të vazhdojnë studimet e filluara në ndonjë universitet tjetër shqiptar , publik dhe jopublik ,të huaj,. Në këto raste krijohet një Komision Vlerësimi me urdhër të Rektorit, pranë departamentit përkatës. Studentët e Universitetit Aldent lejohen të rregjistrohen dhe të vazhdojnë studimet në një universitet tjetër. C`regjistrimi kryhet vetëm në fund të vitit.

Të dhëna për punësimin e studentëve



Nuk ka ende te diplomuar

Numri total të diplomuarve

Nuk ka ende te diplomuar

Numri total i të punësuarve (në përputhje me diplomën)

Nuk ka ende te diplomuar

Numri total i të punësuarve (jo në përputhje me diplomën)

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi IV.1 - Studentët kanë të drejtë të ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.	
<p>Kriteri 1 Studentët që ndjekin programet e studimeve “Master i Shkencave” apo “Master Profesional” zotërojnë së paku diplomën universitare “Bachelor” dhe kanë grumbulluar 180 kredite ECTS;</p> <p>Kriteri 2 Pranimi në programet e integruara të studimeve bëhet në përputhje me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore në fuqi;</p> <p>Kriteri 3 Studentët plotësojnë kriteret e pranimit të përcaktuara nga institucioni;</p> <p>Kriteri 4 Studentët e këtyre programeve të studimit japin deri në diplomim edhe provimin e gjuhës angleze mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare. Për programet e studimeve “Master Profesional” niveli i gjuhës angleze është B2, ndërsa për programet e studimeve “Master i Shkencave” dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë niveli i gjuhës angleze është C1, sipas Kuadrit European të Gjuhëve;</p> <p>Kriteri 5 Institucioni vlerëson herë pas here politikat e pranimit dhe ndikimin e tyre në përparimin e mëtejshëm të studentëve në programin e studimit, si dhe harton plane të mundshme për ndryshimin e kriterëve të pranimit.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion dhe njohjen me dokumentacionin përkatës GVJ konstatoi se pranimi i studentëve në programin MP. në “Teknologji Dentare e Avancuar” është kryer në mbështetje të ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", si dhe urdhërat dhe udhëzimet që nxjerr Ministria e Arsimit.</p> <p>Senati Akademik i Universitetit “ALDENT” me vendimin Nr 47, datë 30.12.2016 ka përcaktuar kriteret e pranimit të institucionit për këtë program studimi.</p> <p>Studentët e pranuar në programin e studimit “MP” në “Teknologji Dentare e Avancuar” kishin diplomën Bachelor në Laborant Dentar dhe kishin fituar 180 kredite.</p> <p>Universiteti vlerësonte politikat e pranimit.</p>
Standardi IV. 2- Institucioni informon studentët në lidhje me: statusin e institucionit, të	

programeve të studimeve që ofron dhe me politikat e punësimit.

Kriteri 1 Studentëve u jepet informacion për mundësitë për punësim pas diplomimit në përfundim të këtyre programeve të studimeve;

Kriteri 2 Studentëve u jepet informacion për akreditimin e institucionit dhe të programeve të studimeve që ofrohen si edhe për njohjen dhe vlefshmërinë, brenda dhe jashtë vendit, të diplomës së lëshuar nga ky institucion;

Kriteri 3 Studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës.

Në takimet që patëm me studentët e programit të studimit Master Profesional në “Teknologji Dentare e Avancuar” u informuam mbi mënyrën se si ata marrin informacione të ndryshme mbi programin e studimit që atyre u ofrohet dhe mundësitë për punësim pas diplomimit të tyre në përfundim të këtij programi studimi.

Në Grupin e RVB një anetar ishte student i programit.

Në takimet në institucion me stafin akademik u njohëm me faktin se studentët e UA nuk kanë patur probleme me njohjen e diplomës edhe jashtë vendit. Institucioni i ndihmonte këta studentë me dokumentacionin e nevojshëm për procesin e njohjes së diplomës..

Për dhënien e informacionit, Institucioni ve në dispozicion të studentëve Zyren e Këshillimit të Karrierës. Kjo zyre organizon leksione të hapura, takime, seminare profesionale ku studentët e informohen hollësisht për mundësitë e punësimit .

Standardi IV. 3- Institucioni, kur aplikon për vlerësimin dhe akreditimin për herë të dytë, disponon statistika në lidhje me numrin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.

Kriteri 1 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e të diplomuarve në programet e studimeve që kanë përfunduar;

Kriteri 2 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, tërheqet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik;

Kriteri 3 Institucion disponon të dhëna për ecurinë akademike të studentëve që nga pranimi deri në diplomim.

Gjatë vizitës në institucion dhe njohjen me dokumentacionin perkates GVJ konstatoi se UA disponon të dhëna të plota për cdo student në format elektronik dhe të shkruar, për numrin e të diplomuarve.

Ky program nuk ka ende të diplomuar.

Në sekretarinë mesimore ka të dhëna për studentët e regjistruar, për studentët që largohen nga programi apo ndërpresin studimet për arsye të ndryshme. Ecuria akademike e studentëve mbahet e plotë.

Në sekretarinë e institucionit ka regjistër të notave, regjistër të diplomave.

Disponohen regjistrat fizikë dhe elektronikë të matrikullimit, notave dhe diplomave të studentëve të cilët plotësoheshin, ruheshin dhe arkivoheshin konform legjislacionit dhe akteve nënligjore në fuqi.

Standardi IV. 4- Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me statistikat e punësimit të studentëve që janë diplomuar pas përfundimit të programeve e studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë.

Kriteri 1 Institucioni mban një bazë të dhënash të studentëve të punësuar pas përfundimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë apo të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë si dhe për vendet e punësimit të tyre;

Kriteri 2 Institucioni mban një bazë të dhënash për studentët që vazhdojnë studimet e mëtejshme në ciklet e tjera të studimeve etj.

Gjate vizitës në institucion u njohëm me faktin që Universiteti Aldent ka krijuar një rrjet online me studentët e diplomuar të cilet ndanin eksperiencat e tyre në fushat përkatëse të studimit apo punësimit .

UA kishte një bazë të dhënash për studentët e diplomuar ,për studimet e tyre të mëtejshme ,punësimin etj.

Përfaqësuesit e Zyrës së Karrierës organizonin takime me ish studentë të UAL dhe studentëve aktual.

Standardi IV. 5- Institucioni informon studentët në mënyrë të vazhdueshme dhe të detajuar, në lidhje me programet e studimeve.

Kriteri 1 Studentët informohen në mënyrë të detajuar për programet e studimeve, afatin e përfundimit dhe organizimin e programit, statusin e akreditimit të programit;

Kriteri 2 Studentët informohen për rezultatet e vlerësimit gjatë dhe në përfundim të programit;

Kriteri 3 Përgjegjësi i modulit diskuton hapur me studentët rezultatet e këtyre vlerësimeve.

UAL informonte studentët e çdo programi studimi lidhur me programin e studimit qe ata ndjekin, afatin e përfundimit dhe organizimin e programit, statusin e akreditimit të programit; proceset e akreditimit, liçensimit, etj të cilat diskutoheshin në orët e parashikuara për tutoriatin .Studentë përfaqësues të qeverisë studentore. përfshiheshin në grupet e vlerësimit të brendshëm gjatë procesit të akreditimit.

Studentët e programit të studimit MP. në Teknologji Dentare e Avancuar ishin njohur që ne aplikim me përmbajtjen e programit të studimit nepermjet e-mailit personal dhe web-it te universitetit

Studentët informoheshin për rezultatet e tyre gjatë vitit ,moduleve dhe provimeve te lëndëve perkatese. Studentëve që kerkonin të diskutonin rezultatet e tyre e kishin gjithmonë mundësinë me pedagogun përkatës.

Standardi IV. 6- Institucioni angazhon personelin e tij për përkujdesjen ndaj studentëve.

Kriteri 1 Institucioni u ofron këshillim studentëve, ndjek ecurinë e tyre dhe i ndihmon për trajtimin dhe zgjidhjen e çështjeve dhe problematikave që lidhen me procesin mësimor;

Kriteri 2 Institucioni (nëpërmjet zyrës për këshillimin e karrierës) ndihmon studentët në përzgjedhjen e institucionit në të cilin ata do të zhvillojnë praktikën profesionale, në rastet kur parashikohet një e tillë.

Sistemit te tutoriatit edhe stafi mësimdhënës dhe mbështetës është i angazhuar në ndjekjen e ecurisë së studentëve dhe i ndihmon ata për trajtimin dhe zgjidhjen e çështjeve dhe problematikave që lidhen me procesin mësimor

UAL ka marrëveshje bashkëpunimi me një laborator dentar duke i ndihmuar studentët per zhvillimin e praktikave profesionale.

Zyra e Karrierës në ALDENT u vinte në ndihmë të gjithë studentëve, per tu orientuar në tregun e punës.

Konkluzionet e vlerësimit

1. Pranimi i studentëve në programin MP. në "Teknologji Dentare e Avancuar" është kryer në mbështetje të ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", si dhe urdhërat dhe udhëzimet

që nxjerr Ministria e Arsimit;

2. Institucioni informon studentët në lidhje me: statusin e institucionit, të programit MP. në “Teknologji Dentare e Avancuar” që ofron;
3. Prane institucionit funksionon Zyra e Këshillimit të Karrierës që asiston studentet me politikat e punësimit;
4. Institucioni dispononte statistika për numrin e studentëve të rregjistruar, të çrregjistruar, të larguar për programin MP. në “Teknologji Dentare e Avancuar”;
5. Institucioni dispononte të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë ndjekjes së studimeve që nga pranimit;
6. Funksiononte sistemi i tutoriatit i cili ndihmon për trajtimin dhe zgjidhjen e çështjeve dhe problematikave që lidhen me procesin mësimor;

KËRKIMI SHKENCOR NË FUNKSION TË PROGRAMIT TË STUDIMIT.

10. Kërkimi shkencor

Term reference: politikat e kërkimit shkencor në këtë program studimi, botimet në vite, projektet e fituara dhe të realizuara, pjesëmarrja në aktivitetet brenda dhe jashtë vendit, aktivitetet e organizuara nga njësia, lidhja e kërkimit me mësimdhënien.

Universiteti Aldent përveç procesit mësimor është i angazhuar edhe në kërkimin shkencor. Anëtarët e departamentit laborant dentar kanë bërë botime në revista brenda vendit dhe jashtë vendit me faktor impakti, kanë realizuar një numër të madh referimesh, prezantimesh në aktivitete shkencore kombetare dhe ndërkombëtare. Infrastruktura e pasur me laboratore (28 gjithsej) e UAL e pajisur me aparatura bashkëkohore instrumentare, materiale cilësore për realizimin e eksperimenteve, teknikave të reja laboratorike, metodave të reja mjekuese është në shërbim të kërkimit shkencor.

UA ka qenë bashkëorganizator në Konferencën e Shkencave Mjekesore, Simpoziumin e 2-të Nderkombëtar të Ortodontisë, Kongresit e 4-t Mbarëkombëtar Shqiptar, ku stafi akademik dhe studentet kanë marrë pjesë aktive. Në Universitetin ALDENT në çdo fillim viti akademik planifikohet pjesëmarrja në aktivitete shkencore, projekte dhe prezantime të ndryshme e stafit efektiv .

Ne kuader të një marreveshje bashkepunimi midis UA dhe Clalit Smile (pjesë e Clalit Health Services Group, Izrael) këtë vit akademik Fakulteti i Shkencave Dentare, organizoi trajnimin 6 ditor me temë “Complete Denture Treatment of Edentulous Patients” ku 10 mjekë izraelite u trajnuan nga dy tutore mjekë stomatolog shqiptare Dr.Sh Brunilda Koci (shefe e departamentit të Stomatologjisë pranë Universitetit Aldent) si edhe Dr.Sh Emin Kuzumi.

Studentet e programit të studimit Master Profesional në Teknologji Dentare e Avancuar ishin pjesëmarrës aktiv në këtë workshop duke përgatitur të gjitha punimet laboratorike për 20 pacientet e këtij trajnimi. Në lidhje me projektin me palën izraelite Universiteti Aldent konsideroi nevojat dentare dhe pamundësitë financiare të personave të moshës së tretë duke zgjedhur 20 paciente edentuloze (gra dhe burra). U realizuan për ta 20 proteza totale (falas) me vlerë totale financiare prej 8,000 euro. Edhe pas mbarimit të projektit stafi i Universitetit Aldent (mjekë dhe student të MP në “Teknologji Dentare e Avancuar”) janë duke u ofruar 20 përfituesve shqiptarë të projektit asistencë të vazhdueshme dentale falas në lidhje me problemet që shfaqin herë pas here protezat e lëvizshme.

UA organizonte Konferencën e përvitshme studentore ku studentet, të udhëhequr nga pedagogët paraqesin prezantime të punimeve të tyre. Studentët nxiteshin të merrnin pjesë jo vetëm në aktivitetet shkencore brenda institucionit por edhe jashtë tij.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Të dhëna për kërkimin shkencor

Aktivitetet e kërkimit shkencor janë në nivel individual, dhe përfshijnë botime të personelit akademik, angazhim në projekte, pjesëmarrësve në aktivitete shkencore brenda IAL-se si dhe përfshirja e studentëve në punime shkencore .

Te dhena me te hollësishme paraqiten ne tabelen nr. 18 ne Aneks

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi III.3 - Personeli akademik angazhohet në veprimtari shkencore të organizuara në kuadër të programit të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Personeli akademik publikon rregullisht artikuj, materiale shkencore në disiplinën përkatëse;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik, nëpërmjet angazhimeve në këto veprimtari jep ndihmesën e tij në zhvillimin e shkencës ose në zhvillimin e sektorëve të prodhimit apo të shërbimit.</p>	<p>Personeli akademik ka mbështetjen e Institucionit në kërkimin shkencor dhe pjesëmarrjen në projekte.</p> <p>Personeli akademik i Fakultetit të Shkencave Dentare publikon artikuj në revista brenda dhe jashtë vendit dhe merr pjesë rregullisht në konferenca, seminare, kongrese brenda dhe jashtë vendit me prezantime orale, postera</p> <p>UA angazhohet edhe në edukimin në vazhdim duke organizuar trajnime të ndryshme me pjesëmarrje të laboranteve të huaj për studentet laborant dentar të këtij programi. Personeli akademik i cdo fakulteti të Universitetit Aldent publikon dhe merr pjesë rregullisht në konferenca, seminare , kongrese brenda dhe jashtë vendit me prezantime orale, postera, etj</p>
Standardi III.4 - Institucioni ofron programe mësimdhënieje edhe në gjuhë të huaj, me një personel akademik të kualifikuar.	
<p>Kriteri 1 Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie në gjuhë të huaj ka kryer studimet universitare në atë gjuhë ose zotëron një certificate për njohje të avancuar të saj;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie në gjuhë të huaj ka një përvojë në mësimdhënie në atë gjuhë, prej së paku një semestri.</p>	<p>Mësimi në Universitetin Aldent dhe programin MP në “Teknologji Dentare e Avancuar” zhvillohet në gjuhën shqipe.</p> <p>Institucioni ka vënë në dispozicion të studentëve literaturë bashkëkohore të huaj</p>
Standardi III.10 - Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe të mëtejshëm të personelit të tij.	

<p>Kriteri 1 Institucioni organizon programe specifike për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimorshkencor;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni u ofron personelit akademik dhe atij mësimor-shkencor mundësinë e kualifikimeve të mëtejshme brenda dhe jashtë vendit.</p>	<p>UA i jep një rëndësi të veçantë kualifikimit të vazhdueshëm profesional të personelit akademik duke nxitur dhe mbështetur financiarisht pjesëmarrjen aktive në organizime shkencore, trajnime, kualifikime brenda dhe jashtë vendit.</p>
<p>Standardi III.11 - Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me veprimtarinë kërkimore-shkencore të personelit akademik të tij.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni disponon një bazë të dhënash të studimeve shkencore të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon një bazë të dhënash për botimet (tekste, monografi, libra, artikuj apo kumtesa në konferenca) brenda e jashtë vendit të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni disponon një bazë të dhënash për projektet kërkimore shkencore kombëtare e ndërkombëtare në të cilat ka marrë ose merr pjesë personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi.</p>	<p>Ky institucion disponon një bazë të dhënash të veprimtarisë shkencore të stafit akademik të angazhuar në këtë program studimi</p> <p>Çdo pedagog ka dosjen e tij me veprimtarinë shkencore, dosje e cila përditësohet vazhdimisht.</p> <p>Këto të dhëna gjenden edhe online në faqen zyrtare të UAL.</p>
<p><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Stafit akademik i Fakultetit të Shkencave Dentare publikon artikuj në revista brenda dhe jashtë vendit dhe merr pjesë aktive në konferenca, seminare, kongrese, trajnime, kualifikime brenda dhe jashtë vendit; 2. Institucioni është i angazhuar për kualifikimin e vazhdueshëm dhe të mëtejshëm të personelit të tij duke e nxitur dhe mbështetur financiarisht; 3. Institucioni disponon një bazë të dhënash të veprimtarisë shkencore të stafit akademik të angazhuar në këtë program studimi e cila përditësohet; 4. Çdo pedagog ka dosjen e tij me veprimtarinë shkencore që përditësohet; 5. Institucioni ka vënë në dispozicion të studentëve literaturë bashkëkohore të huaj; 	

11. Bashkëpunimi kombëtar, ndërkombëtar dhe marrëdhëniet me publikun

Pjesa përshkrimore

Terma reference: bashkëpunimi me institucionet e tjera në nivel lokal, kombëtar apo ndërkombëtar, mobiliteti i personelit akademik në secilin nga nivelet e sipërpërmendura, pjesëmarrja në programe kombëtare dhe ndërkombëtare, lidhjet me komunitetin e biznesit dhe me tregun e punës.

Në takimet me drejtuesit e universitetit u theksua se një nga prioritetet kryesore të Universitetit Aldent është bashkëpunimi me institucionet homologe dhe krijimin e partneriteteve brenda dhe jashtë vendit.

Për të permbushur këte qëllim Universiteti Aldent kishte hartuar një program bashkëpunimi afatshkurtër dhe afatmesëm me universitete, institucione të ndryshme, kompani prodhuese dhe organizata vendase e të huaja.

Bashkëpunimi me Universitete, Institucione dhe organizata vendase dhe të rajonit.

UA ka marrëveshje bashkëpunimi me Universitetin e Mjekësisë Tiranë, Kolegjin "ILIRIA"- Fakulteti i Shkencave Mjekësore-Prishtinë, Qendrën spitalore universitare "Nënë Tereza", "Spitalin e Traumës" Tiranë, Shoqatën Dentare Shqiptare, Shoqatën e Pedodontëve, Qendra Kombtare e Edukimit në Vazhdim, Shoqëria "Dental Leader Corsi", Shoqëria e Sigurimit ALBSIG SHA.

Bashkëpunimi me universitete dhe institucione ndërkombëtare

Marrëveshje e bashkëpunimit me Universita degli studi "G. D'Annunzio" Chieti, Pescara në Itali.

Studentët e studimeve pasuniversitare të Universitetit të "Gabriele d'Annunzio", të Chietit, në Itali do të kenë mundësinë e kryerjes së aktiviteteve kërkimore në UA, për një periudhë nga 12 muaj deri në 18 muaj, nën mbikqyrjen e një profesori ose kërkuesi pranë Universitetit Aldent.

Me Universiteti. D'Annunzio i Chieti, Itali gjatë vitit akademik 2018-2019 po realizohet shkëmbimi i 3 studentëve nga dega e farmacistë-Universiteti Aldent për një periudhë 4 mujore si dhe shkëmbimi i 1 stafi akademik të Universiteti i Chietit. Kurse nga Universiteti D'Annunzio i Chieti kanë ardhur 2 studentë italiane që po ndjekin studimet akademike në degën e farmacistë për një periudhë 4 mujore. Marrëveshje bashkëpunimi me Qendrën Spitalore dhe Shtëpinë e Shërbimit "Centro Ospedale e Casa di Cura "San Giovanni XXIII", Monastier di Treviso në Itali. Qendra e Odontostomatologjisë dhe Ortodoncisë në këtë Qëndër Spitalore, merret me odontostomatologji, ortodonci dhe kirurgji maksilofaciale dhe orale. Prej vitit 2010 Universiteti Aldent ka një marrëveshje bashkëpunimi me seksionin e Edukimit të kompanisë 3M ESPE, për prodhimin e materialeve dentare. 3M ESPE ka kryer në universitetin ALDENT workshope, trajnime, për studentët dhe stafin në fushën e Dentistrisë, Endodoncisë dhe Protetikës Fikse. Marrëveshje bashkëpunimi me Universitetin Nikolla Koperniku, Poloni;-Universiteti i Shkencave Mjekësore, Lituani. Me këto universitete do të bashkëpunohet për shkëmbimin e studentëve, stafit administrativ dhe akademikë në kuadrin e programit Erasmus + me një kohëzgjatje 2 vjecare.

Marrëveshje bashkëpunimi me:-Universitetin Istinyie, Stamboll Turqi.-Universitetin Acibadem, Stamboll, Turqi. Profesorë e specialistë të huaj , të njohur ,të fushave të ndryshme të dentistrise, kanë qënë të ftuar nga UAL duke dhënë leksione dhe trajnime të ndryshme .

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Të dhëna për bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar

Numri i leksioneve/seminareve me lektorë të huaj është 50, numri i pjesëmarrjeve në trajnime jashtë vendit 6, dhe numri i prezantimeve në aktivitete/konferenca jashtë vendit 12

Komunikimi dhe bashkëpunimi me institucionet e tjera shtetërore, organizata profesionale, komunitetin e biznesit, tregun e punës dhe aktorë të tjerë shoqërorë të rëndësishëm për arsimin e lartë

Bashkëpunimi me institucionet e tjera konsiston në veprimtari të përbashkëta shkencore, projekte, shkëmbim stafi e studentesh, si dhe praktikë mësimore dhe profesionale të studenteve.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi V. 3- Institucioni ka marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë të biznesit vendas apo të huaj për kryerjen e praktikave të studentëve të tij.	
<p>Kriteri 1 Për kryerjen e praktikave të ndryshme të parashikuara për realizimin e programit të studimeve “Master Profesional”, institucioni dëshmon se ka marrëdhënie bashkëpunimi me ndërmarrje apo sipërmarrje nga fusha e tregtisë, industrisë apo e shërbimeve prodhuese;</p> <p>Kriteri 2 Për kryerjen e praktikave të ndryshme në programin e studimeve “Master i Shkencave” ose në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, institucioni dëshmon se ka marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë të ndryshëm nga sfera publike dhe ajo private që mundësojnë përfitimin e njohurive më të mira profesionale nga ana e studentit.</p>	<p>Universiteti Aldent ka marrëveshje bashkëpunimi me laboratorë dentare private ku studentët e programit MP në “Teknologji Dentare e Avancuar” kryejnë praktikat profesionale gjatë vitit të studimit.</p> <p>Në bashkëpunim me këto laboratore realizohen trajnime ,leksione,workshope me lektore vendas dhe të huaj me përfitime profesionale nga ana e studenteve.</p>
Standardi VII.1 - Institucioni garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi mes personelit të tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni, për hartimin dhe mbikëqyrjen e programit, nxit bashkëpunimin ndërmjet personelit brenda institucionit nëpërmjet shkëmbimit të informacionit;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni, nëpërmjet ndarjes së detyrave mes personelit Brenda institucionit, marrjes së përgjegjësive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre, garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi.</p>	<p>GVJ konstaton se institucioni nxit bashkëpunimin ndërmjet personelit brenda institucionit.</p> <p>Institucioni, nëpërmjet ndarjes së detyrave mes personelit brenda institucionit, marrjes së përgjegjësive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre, garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi.</p> <p>Çdo informacion i rëndësishëm rreth aktiviteteve shkencore që organizohen brenda dhe jashtë vendit, artikuj, të reja në fushat mjekësore i përcillen stafit nëpërmjet adresave të brendshme elektronike.</p> <p>Stafi akademik angazhohet vazhdimisht në grupe pune për qëllime të ndryshme mesimore dhe kerkimore-shkencore.</p>
Standardi VII.2 - Institucioni garanton marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj.	
<p>Kriteri 1 Institucioni për realizimin e objektivave të programeve të studimeve ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të programeve</p>	<p>GVJ i njohur me dokumentacionin përkatës, konstaton se institucioni ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe jashtë vendit ,kompani te tregut dentar,aktorë e biznesit vendas ose të huaj.</p> <p>Në marrëveshjet e bashkëpunimit të Universitetit Aldent me institucionet e huaja nga insitucioni asiston me mjete financiare lëvizjen e personelit dhe</p>

<p>të studimeve që ofron;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni organizon trajnime profesionale të mëtejshme në bashkërendim me punëdhënësit;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni bën një raport analitik të përfitimeve nga marrëveshjet kontraktuale në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p>	<p>studentëve. Institucioni organizon trajnime profesionale në kuadër të edukimit në vazhdimësi në fushën e laborantëve dentar .</p>
<p><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. UAL ka marrëveshje bashkëpunimi me universitete homologe brenda dhe jashtë vendit, laborator dentar, kompani te tregut dentar, aktor te biznesit vendas dhe te huaj; 2. Instutucioni nxit dhe ka krijuar kushte për bashkëpunim të frutshëm mes personelit të tij; 3. Institucioni organizon trajnime profesionale në kuadër të edukimit në vazhdimësi ne fushën e laborantëve dentar; 	

I. ANALIZA PËRMBLEDHËSE E RVJ SIPAS METODËS SWOT (STRENGTHS-PIKAT E FORTA, WEAKNESSES- PIKAT E DOBËTA, OPPORTUNITIES-MUNDËSITË, THREATS-PENGESAT).

a. Pika të forta:

1. UAL është i vetmi institucion që ofron Masterin Profesional në “Teknologji Dentare e Avancuar”;
2. Hapja e programit Masterin Profesional në “Teknologji Dentare e Avancuar” është bërë në përputhje me nevojat në rritje të shërbimit dentar për punime të teknologjisë së avancuar në fushën e protetikës, ortodoncise, implantoprotezës;
3. Hartimi i programit është realizuar nga profesionistë të fushës me eksperiencë të gjatë në mësimdhënie;
4. Staf i akademik që realizon këtë program ka eksperiencë akademike dhe profesionale;
5. Infrastruktura e pasur me laboratorë të pajisur me aparatura moderne ,instruementar, materiale cilësore, bëjnë të mundur aftësimin profesional të studentëve. Ka asistencë të vazhdueshme për mirëmbajtjen e infrastrukturës;
6. Investime të vazhdueshme në blerje pajisjesh dhe materialesh laboratorike në shërbim të procesit mësimor dhe kërkimor-shkencor;
7. Funksionon shërbimi i tutoriatit duke ndjekur studentët në vazhdimësi;
8. Bibliotek e pasur me tituj librash dhe funksionimi i bibliotekës on line HINAR.;
9. Marrëveshje bashkëpunimi me univeritete homologe brenda dhe jashtë vendit me mundësi mobiliteti, kompani dentare, aktor të biznesit;
10. Përfshirje dhe inkurajim i studentëve dhe stafit akademik në veprimtari kërkimore-shkencore;
11. UAL përdor platformen FxEducation ku studentët kanë akses në informacionet e nevojshme për ta;

b. Pika të dobëta:

1. Mungojnë botimet për laborantë dentar në gjuhën shqipe;
2. Akses i kufizuar në grante dhe financime te BE për shtetet jo anëtarë;
3. Mungojnë ambientet sportive

c. Mundësitë:

1. Të merren masa për botime në gjuhën shqipe të teksteve për laborantë dentar;
2. Të shihet mundësia e ambienteve sportive dhe fasiliteve që e bëjnë më të larmishme jetën universitare;
3. Të rritet aksesimi për financime dhe grante;

d. Pengesat:

1. Vështirësi për aplikimin për projekte ,financime brenda dhe jashtë vendit në fushën e shërbimit dentar;
2. Mungesa për një kohë të gjatë e ofrimit të programeve të studimit të ciklit të tretë të doktoraturës;

Rekomandime:

Të punohet për botimin e librave në shqip për laborantët dentarë;

Institucioni të punojë për të patur akses në grantet dhe financimet e BE për vendet jo anëtare;

Të merren masa për ngritjen dhe vënien në shërbim të studentëve të ambienteve sportive;

II. SWOT ANALYSIS

a. Strengths:

1. UAL is the only institution that offers the Professional Masters in “Advanced Dental Technology”;
2. The Professional Masters program in “Advanced Dental Technology” is done in accordance to the growing dental service needs for dental works of advanced technology in the fields of prothetics, orthodontics and implanto-prosthetics;
3. The program plan is created by professionals of the field highly experienced in teaching;
4. The academic staff of this program have academic and professional experience;
5. The infrastructure that includes laboratories equipped with modern equipments, instruments and high quality materials, makes possible the professional development of students. There is continuous assistance for the upkeep of the infrastructure;
6. Continuous investments in the purchasing of equipment and laboratory materials to serve the academic and research process;
7. There is a tutor program following the students’ development;
8. A well equipped library with a variety of book titles and the online library source HINAR;

9. Cooperation agreements with homologous national and international universities with mobility, dental companies, business actor opportunities;
10. Involvement and encouragement of students and the academic staff in research projects;
11. UAL uses the FxEducation platform where their students have access to any needed information;

b. Weaknesses:

1. There is a lack of publications in Albanian for dental technicians;
2. Limited access to EU grants and funding for non-member status;
3. Lack of sports facilities;

c. Opportunities:

1. Take measures about publications in Albanian for dental technicians;
2. Explore the opportunities of creating sporting facilities in order to improve the university life;
3. Grow access to grants and funds;

d. Threats:

1. Difficulties in applying for projects, funds nationally and internationally in the field of dental public service;
2. The long time lack of offering third cycle of doctorate study programs;

Recomandations:

- *Work towards publishing books in Albanian for dental technicians;*
- *The institution should work towards accessing grants of EU for non member countries;*
- *Measures should be taken for the construction and putting in service of the students of sports facilities;*

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Prof.Asoc Nazmi Koci

Prof.Asoc Etleva Qeli (Droboniku)